



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 445 Akti

Nr. 537 Vendimi
Tiranë, më 2.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datat 20.4.2022, ora 10:00 dhe 27.5.2022, ora 09:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Florian Bonjaku**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Steven Kessler, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Florian Bonjaku, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 16.12.2019 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine (kryesuese), Valbona Sanxhaktari (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua, z. Steven Kessler.
- 3.** Me vendimin e datës 23.1.2020, trupi gjykues vendosi fillimin e hetimit administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.
- 4.** Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
- 5.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
- 6.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
- 7.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, si dhe njoftimin tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 15.3.2022¹ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni. Nga subjekti i rivlerësimit u kërkuar zgjatje afati për dorëzimin e prapësimeve dhe dokumentacionit mbështetës.

9. Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit duke i caktuar një afat të ri deri në datën 14.4.2022. Subjekti brenda këtij afati dërgoi me postë elektronike dhe dorazi pranë Komisionit prapësimet e tij dhe provat mbështetëse.

10. Subjekti i rivlerësimit në datën 14.4.2022 u ftua në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 20.4.2022, ora 10:00.

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.4.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në seancën e datës 27.4.2022, Komisioni i njoftoi subjektin shtyrjen e datës së shpalljes së vendimit me arsyen e kryerjes së disa hetime të tjera shtesë në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit me sip. 69.4 m², duke i njoftuar në datën 20.5.2022 rezultatet e hetimit shtesë. Komisioni njoftoi subjektin për zhvillimin e seancës së radhës në datën 27.5.2022, ora 09:00.

13. Në datën 25.5.2022, subjekti dërgoi pranë Komisionit shpjegime dhe prova për rezultatin shtesë të hetimit.

14. Komisioni në seancën e datës 27.5.2022 njoftoi subjektin se për arsye objektive, seanca e shpalljes së vendimit është shtyrë në datën 2.6.2022, ora 09:45.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Z. Florian Bonjaku ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

17. Për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i

¹Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike.

rivlerësimin përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

18. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

19. ILDKPKI-ja², në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin Florian Bonjaku, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka paqartësi dhe mospërputhje lidhur me vlerat dhe burimet financiare të përdorura për pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

20. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimin të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimin dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimin.

21. Subjekti i rivlerësimin Florian Bonjaku e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 25.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimin në deklaratën e pasurisë, shtojca 2 (deklarata *Vetting*), janë si vijojnë:

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 62.95 m², me vlerë 100,000 lekë, Durrës

1.1 Pasuria apartament banimi, me sipërfaqe 62.95 m², është blerë me kontratën nr. ***, datë 11.6.2003, në vlerën 100,000 lekë, me vendndodhje rruga “****”, Lagjja ***, nr. ***, shk. ***, k. ***, p. ***, Durrës. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

1.2 Subjekti i rivlerësimin, gjithashtu, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se: “*Këtë apartament ia kam blerë jo realisht vetëm për qëllim dokumentacioni (fiktivisht) prindërve të bashkëshortes*”

²Raporti nr. *** prot., datë 9.7.2019, i ILDKPKI-së.

sime. Ky apartament është blerë vetëm për arsye dokumentacioni me qëllimin për të bërë të mundur marrjen e një kredie në NBG për blerjen e apartamentit në blv. '***', Tiranë, pasi banka nuk jepte kredi nëse shtëpia që do blihej ishte e paregjistruar në ZVRPP dhe ky apartament ishte në ndërtim e sipër. Kjo shtëpi nuk është zotëruar kurrë nga unë, por është zotëruar dhe zotërohet nga prindërit e bashkëshortes sime të cilët jetojnë aty pa asnjë ndërprerje që nga viti 1996, kur është blerë nga prindërit e bashkëshortes”.

1.3 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 (në vijim DIPP), subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi ndërtuar para 1990 me sip. 75 m², me vlerë 3,500,000 lekë, me adresë Lagjja ***, rr. ***, p. **, Durrës. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kredi pranë NBG-së”.

1.4 Subjekti ka depozituar kontratë shitje “me pagesë të menjëhershme”, datë 11.6.2003³, me shitës H. H. dhe blerës Florian dhe S. Bonjaku (H.), për apartamentin me sip. 62.95 m², me çmim të përgjithshëm 100,000 lekë, paguar *cash*.

1.5 ASHK-ja Durrës⁴ konfirmon pronësinë e këtij apartamenti në emër të shtetasve Florian dhe S. Bonjaku, blerë nga H. H. (vjehtëri i subjektit), sipas kontratës referuar më lart. Nga dokumentacioni i ASHK-së rezulton se shtetasi H. H. e ka përfituar më parë këtë apartament me kontratën e shitblerjes së datës 3.1.1997⁵ nga shitësit B. H. etj., për çmimin 400,000 lekë.

1.6 Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka pyetur subjektin për mospërputhjen e vlerës së deklaruar për këtë apartament pasqyruar në DIPP-në e vitit 2003, në shumën 3,500,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitblerjes pasqyrohet vlera 100,000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se vlera 3,500,000 lekë është vlera e vlerësimit të bërë nga banka me qëllim dhënien e kredisë në vlerën 20,000 USD.

1.7 Në lidhje me mospërputhjet në deklaram⁶ për burimin e krijimit të apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Durrës, subjekti ka shpjeguar se blerja e apartamentit ka ardhur si rezultat i domosdoshmërisë sepse në atë kohë sa ishte martuar dhe nuk mund të jetonin së bashku dy kurora në një apartament 1+1.

1.8 Është pyetur subjekti për faktin që ky apartament vijon ende të jetë në pronësi të subjektit dhe jo në emër të prindërve të bashkëshortes që sipas deklaramit të subjektit është realisht në posedim dhe në pronësi të tyre, ai ka shpjeguar se kjo ka ndodhur për shkak të marrëdhënieve të mirëbesimit dhe rrethanat nuk kanë diktuar nevojën për formalizimin dhe rikthimin e kësaj prone.

1.9 Nga “ABI Bank”⁷ është depozituar kontrata e kredisë, datë 13.6.2003, si dhe vënie në hipotekë e pasurisë së paluajtshme⁸, ku në nenin 1 të kësaj kontrate përcaktohet se banka do t`i japë kredimarrësve një kredi në shumën 20,000 USD, me qëllim blerjen e një apartamenti në Durrës. Gjithashtu, është depozituar dhe kontrata e hipotekimit, datë 24.6.2005, ku subjekti ka ndryshuar kolateralin, duke hequr nga barra hipotekore apartamentin në rrugën “***”, Durrës dhe duke e zëvendësuar atë me apartamentin në blv. “***”, Tiranë.

³Kontrata e shitjes nr. ***, datë 11.6.2003.

⁴ASHK-ja Drejtoria Vendore Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2020.

⁵Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 3.1.1997.

⁶Deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 “kredi në NBG” dhe në një kohë që kredia e marrë atë vit në shumën 20,000 USD është përdorur për blerjen e apartamentit me adresë blv. “***”, Tiranë

⁷“ABI Bank”, me shkresat nr. *** pro., datë 5.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 1.12.2021.

⁸ Kontratë e kredisë nr. ***, datë 13.6.2003.

1.10 Në vijim të verifikimit dhe analizës të dokumentacionit bankar të kredisë të përcjellë nga “ABI Bank”, Komisioni ka administruar përgjigjen nga notere M. I.⁹, e cila ka depozituar pranë Komisionit kontratën shitje me rezervë, nr. ***, datë 8.3.2003, me palë shitëse H. H. dhe blerës Florian Bonjaku, për blerjen e apartamentit me sip. 62.95 m², me adresë rruga “***”, p. ***, Durrës, me çmimin 30,000 USD. Ky çmim do paguhet: *kësti I, prej 10,000 USD paguar nga blerësi në datën e sotme jashtë zyrës noteriale; kësti II, prej 20,000 USD do të paguhet nga blerësi, pasi të marrë kredinë nga NBG, por jo më vonë se data 8.6.2003. Pagimi i kështit të II, prej 20,000 USD do dokumentohet me një deklaratë noteriale.*

1.11 Në lidhje me ekzistencën e një kontrate shitje me rezervë dhe një kontrate shitblerje përfundimtare apartamenti, ku janë të përcaktuara çmime të ndryshme, subjekti ka shpjeguar se pas marrjes së pyetësorit nga Komisioni është interesuar dhe ka tërhequr kontratën tek noterja M. I. (të cilën nuk e dispononte për shkak të kohës së kaluar dhe të cilën subjekti nuk e kujtonte se ku e kishte lidhur) dhe nga dokumentacioni rezulton se blerja e apartamentit në Durrës prej tij dhe e bashkëshortes në pronësi të vjehrrit është kryer me qëllimin që të mundësohej blerja e apartamentit në Tiranë. Në praktikën bankare të kohës kur është marrë kredia, banka kreditonte klientët për blerje apartamenti banimi, me kushtin që klienti të kishte pjesëmarrje të vetën, pra, një pjesë të vlerës për blerjen e apartamentit ta paguante vetë klienti. Bankat, në ato vite, kërkonin zakonisht që kjo vlerë të ishte 30% e çmimit të blerjes së pasurisë që kreditohet. Edhe pagesa e shumës 10,000 USD, si shumë e paguar nga subjekti në kontratë është pasqyruar, pasi kështu plotësohej kushti i parë që kërkonte banka për pjesëmarrjen e klientit. Në mënyrë që banka të jepte kredinë, kushti tjetër që duhej të plotësohej ishte edhe kolaterali/garancia. Shtëpia e vjehrrit shërbeu edhe si qëllim financimi edhe si garanci për kredinë, pasi ishte shtëpi e regjistruar në hipotekë, por që kredia të disbursohej duhej që paraprakisht të ishte e bllokuar në hipotekë dhe kjo ishte edhe arsyeja që u firmos kontrata e shitblerjes me kusht datë 8.3.2003¹⁰.

Subjekti thekson se kontratat e nënshkruara me vjehrrin kanë pasur qëllim të vetëm, marrjen e kredisë në bankë dhe jo kalimin e pronësisë së kësaj banese në emrin e tij. Realisht nuk ka pasur kalim shume nga subjekti te vjehrrin në shumën 10.000 USD, aq më tepër që për të njëjtën banesë, në datën 11.6.2003 është lidhur kontratë tjetër ndërmjet tij dhe vjehrrit, kontratë e cila është e depozituar edhe në hipotekë. Subjekti shpjegon se të gjitha këto veprime janë sugjeruar nga banka dhe pasi janë bindur me qëllimin e vetëm që të arrinin të merrnin kredinë për të blerë shtëpinë në Tiranë, pasi në atë kohë nuk shikonin asnjë mundësi tjetër.

1.12 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- a) Ka mospërputhje deklarimi për burimin e krijimit të apartamentit me sip. 62.95 m², të ndodhur në rrugën “***”, Durrës, pasi në deklaratën e vitit 2003 deklarohet si burim “*kredi më NBG*”, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar se nuk janë paguar vlera monetare. Kredia është disbursuar në datën 23.6.2003, pas blerjes së apartamentit më 11.6.2003.
- b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e shitjes me rezervë, datë 8.3.2003, me çmimin 30,000 USD, të përdorur për marrjen e kredisë, në deklaratat për vitet 2003 – 2016 dhe në deklaratën *Vetting*.

⁹ Përgjigja e noteres e datës 15.12.2021 drejtuar Komisionit.

¹⁰Për detaje shihni pyetësorin nr. 3, në dosjen e Komisionit.

- c) Ka veprime fiktive të kryera (më shumë se një herë) nga subjekti i rivlerësimit në paraqitjen e dy kontratave me referenca dhe çmime të ndryshme për apartamentin me sip. 62.95 m² për përfitimin e kredisë, veprime këto që duket se subjekti ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.13 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se:

Nuk ka mospërputhje deklarimi për burimin e krijimit të apartamentit me sip. 62.95 m², në rrugën “****”, Durrës, pasi qëllimi i kalimit të pronësisë mbi këtë apartament ka qenë vetëm mundësia që ai do të përdorej si kolateral në kredinë që NBG miratoi në vlerën 20,000 USD, sipas kontratës së datës 11.6.2003.

1.13.1 Në lidhje me mosdeklarimin e kontratës së shitjes me rezervë, datë 8.3.2003, ky veprim juridik është bërë, pikërisht, për marrjen e kredisë me qëllim blerjen e apartamentit te blv. “****”, Tiranë dhe se është bërë deklarimi i kontratës përfundimtare të shitblerjes, si dhe i marrëdhënies së kredisë.

1.13.2 Subjekti ka shpjeguar në lidhje me veprimet fiktive të kryera se kontrata e shitjes me rezervë (por e pa konkluduar), datë 8.3.2003, me çmimin 30,000 USD dhe ajo e datës 11.6.2003, me çmimin 100,000 lekë, kanë pasur si qëllim vetëm marrjen e kredisë dhe nuk është synuar asnjëherë kalimi i pronësisë së banesës së prindërve të bashkëshortes në emrin e subjektit dhe bashkëshortes. Subjekti shpjegoi se për sa kohë këto veprime janë kryer në mirëbesim brenda një rrethi të ngushtë familjar, nuk duhet të konsiderohen si veprime që përfshihen në përcaktimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Kalimi përfundimtar i pronësisë së apartamentit në emër të subjektit dhe të bashkëshortes është bërë po me kërkesë të bankës në mënyrë që të provohej fakti se kredia do të merrej për blerje banese dhe nuk do të shfrytëzohej për biznes sepse në një rast të tillë do të kishte interesa më të larta.

1.13.3 Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ****, datë 21.3.2022, me deklarues H. dhe A. H., prindërit e bashkëshortes, të cilët, ndër të tjera, deklarojnë se në realitet vlera 10,000 USD nuk është paguar nga blerësit sipas kontratës, pasi qëllimi i vetëm i saj ishte mundësia e financimit të kredisë nga banka të paktën në vlerën 30% të kredisë dhe nuk është synuar shitja e pasurisë prej tyre te vajza dhe familja e saj.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

1.14 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me kontratat e shitjes të lidhura me prindërit e bashkëshortes. Nga hetimi administrativ ka rezultuar i provuar se qëllimi i vetëm i këtyre kontratave ka qenë marrja e kredisë dhe jo kalimi i pronësisë së këtij apartamenti. Komisioni mban parasysh dhe origjinën e krijimit të këtij apartamenti ku nga hetimi ka rezultuar se ky apartament është përfituar nga vjehri i subjektit H. H. që në vitin 1997 nga shitësi B. H. etj., ndërsa vetë ky i fundit e kishte përfituar këtë apartament në vitin 1994 nga Ndërmarrja Komunale Banesa Durrës, çka hedh poshtë çdo dyshim për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

1.14.1 Gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit u depozituan kontrata e energjisë elektrike dhe librezat e ujësjellësit që rezultojnë në emër të shtetasit H. H., dokumente këto që

vërtetojnë zotërimin dhe disponimin e këtij apartamenti nga prindërit e bashkëshortes së subjektit në vazhdimësi.

1.14.2 Nga vjehrrit e subjektit është pranuar që për këtë apartament nuk është bërë asnjë pagesë nga subjekti dhe vajza e tyre dhe deklaratimet në kontrata janë bërë vetëm për efekt të marrjes së kredisë. Kjo deklaratë noteriale, dokument ligjor, vërteton se kontrata e shitjes me rezervë nuk është përmbushur në dy prej elementëve themelorë të saj: (a) nuk është bërë pagesa e çmimit sipas përcaktimeve kontraktuale; si dhe (b) nuk është bërë kalimi përfundimtar i pronësisë, çka vërteton qëllimin e lidhjes së saj për përmbushjen e kushteve bankare për marrjen e kredisë, për më tepër që vërtetohet se kalimi përfundimtar i pronësisë së apartamentit në emër të subjektit dhe bashkëshortes është bërë me kontratën e shitblerjes përfundimtare, datë 11.6.2003, për çmimin 100,000 lekë, e regjistruar kjo edhe në regjistrat e pasurisë në ish-ZVRPP-në Durrës.

1.14.3 Në qasjen dhe vlerësimin ndaj veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni mban në konsideratë faktin se: (a) qëllimi i vetëm i kryerjes së këtyre veprimeve ka qenë, pikërisht, marrja e një kredie sipas kushteve të diktuara nga një bankë private e nivelit të dytë dhe jo të një kredie me kushte favorizuese, të subvencionuar edhe nga shteti, me qëllim blerjen e një apartamenti në Tiranë; (b) tërësia e veprimeve të kryera, në kushtet e një marrëdhënieje të posaçme, brenda një rrethi shumë të ngushtë familjar, që konkludojnë me një situatë faktike të njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, e lehtësojnë bindshëm pozitën e subjektit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë; (c) deklarata *Vetting* është dokumenti ligjor bazë ku bazohet procesi i rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë dhe për sa kohë që subjekti ka bërë një deklaram me vërtetësi të situatës mbi këtë apartament, si dhe të marrëdhënies së kredisë përfshirë edhe destinacionin e saj, Komisioni e vlerëson këtë si një element që shkon në favor të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni i vlerëson të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duke konkluduar se veprimet e kryera prej tij, në lidhje me apartamentin, kredinë bankare, destinacionin e saj, deklaramin në deklaratën *Vetting*, marrëdhënien e posaçme në një rreth shumë të ngushtë familjar, mospërfitimin e favoreve në këtë marrëdhënie kredie për shkak të detyrës, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, nuk vlerësohen se arrijnë deri në atë masë sa që ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 112.4 m², me vlerë 8,948,000 lekë, Tiranë

2.1 Pasuria apartament banimi me sipërfaqe 112.4 m², i ndodhur në pallatet ***, shk. ***, k. ***, rruga “***”, lagjja “****”, Tiranë, i blerë në shumën 8,948,000 lekë, me kontratën nr. ***, datë 22.11.2011, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Burimi i krijimit: blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 69.4 m², i ndodhur në k. ***, të banesës ***, në blv. “****”, Tiranë, i shitur me vlerën 9,500,000 lekë.

2.2 Subjekti, po në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “Ky apartament (i shituri) është blerë në datën 17.5.2004, me vlerë 19,432 USD, por realisht ishte prenotuar që në vitin 2003, kur ishte në fazën e ndërtimit. Ky apartament është blerë me lekët e marra me kredi në NBG, në shumën 20,000 USD. Kolateral për këtë kredi fillimisht është lënë apartamenti i banimit në p. ***, Lagjja ***, rruga “***”, Durrës. Sapo apartamenti në blv. ***, Tiranë, është regjistruar në

ZVRPP, është ndryshuar kolaterali i kësaj kredie dhe është vënë ky apartament si kolateral. Kredia e mësipërme është shlyer përpara afatit të saj në datën 22.4.2011”.

2.3 Në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. 112.4 m² të blerë në shumën 8,948,000 lekë, por nuk është deklaruar burimi i krijimit.

2.4 Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes, datë 22.11.2011¹¹, me shitës shoqërinë “****” (në vijim ***) sh.p.k. dhe blerës shtetasit Florian dhe S. Bonjaku, për apartamentin me sip. 112.4 m², me çmimin 8,948,000 lekë, likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

2.5 ASHK-ja¹² konfirmon pasurinë apartament me sip. 112.4 m², nr. pas ***, f. ***, z. k. ***, Tiranë, regjistruar emër të shtetasve Florian dhe S. Bonjaku.

2.6 FSHU-ja¹³ konfirmon kontratën e furnizimit në emër të shtetasit Florian Bonjakut në instancën e Tiranës, në adresën rruga “****”, kabina *** sh.p.k., ndërsa UKT-ja¹⁴ konfirmon kontratën me nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë.

2.7 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 112.4 m² krahasuar me çmimin referues të EKB-së, i cili përcakton të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2011, për qytetin e Tiranës¹⁵, zona ***, ku përfshihet “****”, përcakton çmimi 72,000 lekë/m². Duke llogaritur sipërfaqen me çmimin për metër katror (112.4 + 11.3 m² = 123.7 m² x 72,000 lekë/m²) rezulton se vlera totale është 8,906,400 lekë, sipas vlerës në tregun e lirë. Konstatohet se nuk ka diferenca në çmimin e shitjes krahasuar me çmimin referues të EKB-së.

2.8 Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë *** sh.p.k., datë 15.11.2021, e cila konfirmon se shtetasit Florian dhe S. Bonjaku kanë blerë apartamentin në rrugën “****”, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 22.11.2011.

2.8.1 Nga dokumentacioni i depozituar pranë Komisionit nga kjo shoqëri rezulton se në datën 7.12.2010 është lidhur kontrata e sipërmarrjes së kësaj shoqërie me shtetasin R. Sh., për blerjen e apartamentit me sip. 123.7 m², me vlerë totale 8,948,000 lekë, nga ky i fundit. Likuidimet e kësteve të këtij apartamenti janë bërë në bankat e nivelit të dytë BKT dhe “Tirana Bank”, si dhe me marrëveshje *klering* të gjitha në vitin 2011 (furnizim me çimento i shoqërisë *** sh.p.k., nga shtetasi R. Sh.)¹⁶.

2.8.2 Po kështu, rezulton se subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku në datën 21.11.2011 në një deklaratë jo noteriale të nënshkruar dhe nga shtetasi R. Sh. deklaroi se: “Unë Florian Bonjaku kam blerë pranë shoqërisë *** sh.p.k., një apartament [...] në adresën rr. “****”, Tiranë, me sipërfaqe neto 112.4 m². Pagesat për shlyerjen e këtij apartamenti janë bërë nga R. Sh., i cili

¹¹Kontratë shitje nr. ***, datë 22.11.2011.

¹²ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana-Veri me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2020.

¹³FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2020.

¹⁴UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2020.

¹⁵Udhëzimi nr. ***, datë 23.11.2011, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2011”.

¹⁶Pagesa 700,500 lekë, datë 17.3.2011, në “Tirana Bank”; pagesa 700,500, datë 17.3.2011, në BKT; pagesa 1,400,900 lekë, datë 18.3.2011, në “Tirana Bank”; pagesa 1,400,900 lekë, datë 4.8.2011, në “Tirana Bank”; pagesa 702,550 lekë, datë 16.9.2011, në “Tirana Bank”; pagesa 702,550 lekë, datë 20.9.2011, në “Tirana Bank”; pagesa 704,750 lekë, datë 30.9.2011, në “Tirana Bank”; shuma 2,142,070 lekë, datë 15.10.2011, furnizim-rakordim me *klering* furnizim me çimento; shuma 492,380 lekë, datë 18.11.2011, në “Tirana Bank”. Totali i pagesave në vlerën 8,948,000 lekë.

ka paguar për llogari dhe në emrin tim në llogarinë bankare të shoqërisë *** sh.p.k., në “Tirana Bank”, shumën 8,948,000 lekë”.

2.8.3 Është depozituar dhe aktmarrëveshja “për kalim të drejtash reale”, po e datës 21.11.2011, lidhur ndërmjet shtetasve Florian Bonjaku dhe R. Sh., ku ky i fundit ia kalon apartamentin subjektit me cilësinë e blerësit, pasi subjekti i ka likuiduar *cash* pagesën totale të çmimit në shumën 8,948,000 lekë. Gjithashtu, në këtë aktmarrëveshje përcaktohet se kontrata përfundimtare e shitjes do të realizohet ndërmjet shoqërisë *** sh.p.k. dhe shtetasit Florian Bonjaku, i cili ka likuiduar totalisht R. Sh. për këtë apartament dhe, gjithashtu, ka likuiduar totalisht edhe shoqërinë *** sh.p.k., me pagesa në bankë dhe furnizim me çimento dhe se Florian Bonjaku si blerës i ri nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj shoqërisë për çmimin e apartamentit.

2.8.4 Shoqëria *** sh.p.k. ka depozituar edhe kontratën e shitblerjes së apartamentit, datë 22.11.2011, të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten, me çmimin 8,948,000 lekë deklaruar/paguar shitësit jashtë zyrës noteriale.

2.9 Subjektit i është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen në lidhje me pagesën e çmimit të apartamentit, pasi në kontratën e shitjes, datë 22.11.2011, deklarohet se çmimi 8,948,000 lekë i është paguar shitësit (*** sh.p.k.) jashtë zyrës noteriale, ndërsa në deklaratën jo noteriale, datë 21.11.2011, subjekti deklaroi se pagesat për shlyerjen e apartamentit janë bërë nga shtetasi R. Sh., i cili ka paguar për llogari dhe nën emrin e tij në llogarinë bankare të shoqërisë *** sh.p.k., shumën 8,948,000 lekë.

2.9.1 Subjekti ka shpjeguar se në vitin 2011 ka pasur dëshirë të blinte një apartament banimi dhe zona “****” ishte e përshtatshme dhe me çmime të arsyeshme. Pas interesimit, subjekti ka ardhur në dijeni për kompleksin e banimit, të ndërtuar nga shoqëria *** sh.p.k. dhe se shtetasi R. Sh., në kuadër të marrëdhënies së *kleringut* me shoqërinë kishte prenotuar një apartament në këtë kompleks. Pas kontaktit me këtë person dhe pas shitjes së apartamentit në blv. “****” kanë filluar veprimet për blerjen e apartamentit. Shtetasi R. Sh., për shkak të marrëdhënies së *kleringut* me shoqërinë *** sh.p.k., për furnizim me çimento, kishte lidhur kontratë sipërmarrjeje, datë 21.11.2011, por nuk kishte finalizuar kontratën e shitjes dhe nga shoqëria *** sh.p.k., iu sugjerua që kontrata të realizohej direkt me shoqërinë. Pagesa e apartamentit në fjalë është realizuar nga subjekti në momentin e lidhjes së marrëveshjes së kalimit të të drejtave të datës 21.11.2011 dhe i është paguar porositësit R. Sh., i cili më përpara kishte realizuar vetë tërësisht pagesën që i detyrohej firmës ndërtuese, sipas kontratës së sipërmarrjes që kishin me njëri tjetrin.

Likuidimet ndaj firmës ndërtuese të bëra pjesë-pjesë nga z. R. Sh. u quajtën si pagesa të subjektit në momentin që ai i ka bërë pagesën z. R. Sh., sipas marrëveshjes së kalimit të të drejtave të datës 21.11.2011

2.9.2 Pra, subjekti i ka paguar shtetasit R. Sh. në datën 21.11.2011, shumën 8,948,000 lekë, që ishte vlera e blerjes së apartamentit (siç konfirmohet në marrëveshjen e kalimit të të drejtave të datës 21.11.2011). Burimi i kësaj shumë të paguar prej subjektit janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në blv. “****”, Tiranë, e kryer në datën 25.8.2011.

2.10 Komisioni ka administruar përgjigjet nga “Tirana Bank”¹⁷ dhe BKT¹⁸, të cilat kanë konfirmuar pagesat përkatëse që z. R. Sh. ka derdhur në llogari të shoqërisë *** sh.p.k., sipas pagesave të deklaruara dhe nga vetë shoqëria.

2.11 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë *** sh.p.k., me administratorin A. I. dhe nga hetimi¹⁹ nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

2.12 Për shtetasin R. Sh. janë administruar shkresat e Prokurorive të Rretheve Tiranë, Lushnjë dhe Krujë²⁰. Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton i regjistruar kallëzim në ngarkim të shtetasit R. Sh., por kjo çështje nuk është hetuar nga subjekti i rivlerësimit²¹.

2.13 Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë²² konfirmohet se ndaj shtetasit R. Sh. janë regjistruar 3 (tre) procedime penale, ku 2 (dy)²³ prej të cilëve nuk janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Ndërsa procedimi penal nr. ***²⁴, i cili është hetuar nga një subjekt tjetër, ka të bashkëngjitur vendimin e gjykatës për ankimin e pushimit të këtij procedimi penal, ku në këtë vendim përmendet subjekti Florian Bonjaku, i cili duket se ka pasur një procedim të mëparshëm i bashkuar me këtë të fundit.

2.14 Gjithashtu, Komisioni ka administruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) dokumentin “kërkesë” që i drejtohet drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Krujë, me kallëzues shoqërinë “****” sh.p.k. dhe i kallëzuar shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor R. Sh. dhe B. Sh.. Me këtë kërkesë shoqëria Sh. sh.p.k kërkon transferimin e dosjes penale nr.***, të kallëzimit nr. ***, e cila, më pas, u transformua në dosjen nr. ***. Në këtë dosje sipas ankesës së kërkuesit pretendohet se ka vendime të lëshuara nga subjekti Florian Bonjaku në kushte konflikti i interesit për të mbrojtur korrupsionin.

2.15 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë²⁵ aktet e procedimit penal nr. ***, nga ku rezulton se në datën 5.6.2017, shoqëria “****”, sh.p.k. ka paraqitur kallëzim penal ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor R. Sh. dhe pas hedhjes së shortit nga drejtuesi i prokurorisë në datën 9.6.2017, kjo çështje i është caktuar për hetim subjektit. Subjekti Florian Bonjaku në datën 12.6.2017 i është drejtuar me kërkesë për dorëheqje drejtuesit të prokurorisë, ku i ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kësaj çështje, pasi me shtetasin R. Sh. ka njohje prej vitesh. Nga ana e drejtuesit të prokurorisë në datën 21.9.2017 është marrë vendimi i zëvendësimit të prokurorit të kësaj çështje, ku subjekti Florian Bonjaku zëvendësohet nga prokurori M. K.

2.16 Komisioni vëren se referuar kërkesës së shoqërisë “****” sh.p.k., drejtuar ONM-së, pra, nga dokumentacioni i fashikullit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2022, nga “Tirana Bank”.

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2022, nga BKT.

¹⁹Prokuroria e Rrethit Tiranë me shkresat nr. *** prot., datë 15.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 24.11.2021; Prokuroria e Rrethit Lushnjë me shkresat nr. *** prot., datë 14.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.12.2021; Prokuroria e Rrethit Krujë me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2021.

²⁰Prokuroria e Rrethit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021; Prokuroria e Rrethit Lushnjë me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2021.

²¹Kallëzimi penal nr. ***, i hetuar nga prokurori G. Sh.

²²Prokuroria e Rrethit Krujë nr. *** prot., datë 6.12.2021.

²³Procedimi penal nr. ***, hetuar nga prokurori S. T.; procedimi penal nr. ***, hetuar nga prokurori A. Q.

²⁴Procedimi penal nr. ***, hetuar nga prokurori M. K.

²⁵Prokuroria e Rrethit Krujë ka përcjellë materialet e procedimit penal nr. ***, me rrugë elektronike, datë 13.12.2021.

hetimi i kësaj çështje në momentin që i është caktuar për hetim, duke respektuar ligjin procedural. Subjekti i rivlerësimit nuk është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit apo papajtueshmërie.

2.17 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

- a) nuk ka provuar me dokumentacion ligjor pagesën e kryer *cash* në shumën 8,948,000 lekë, shtetasit R. Sh., për blerjen e apartamentit me sip. 112.4 m²; si dhe
- b) nuk ka deklaruar burimin real të përfitimit të apartamentit me sip. 112.4 m², pasi subjekti ka deklaruar kontratën e shitjes me shoqërinë *** sh.p.k., ndërkohë që pagesat e këtij apartamenti janë bërë fillimisht nga z. R. Sh. shoqërisë *** sh.p.k. dhe, më pas, këtij të fundit i është bërë e gjithë pagesa prej 8,948,000 lekësh, *cash* nga subjekti.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.18 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se pagesa është kryer *cash* ndërmjet dy individëve, pagesë kjo që provohet me deklarinimin e bërë në deklaratën e datës 21.11.2011, me deklarues shtetasit Florian Bonjaku e R. Sh. dhe me aktmarrëveshjen për kalim të drejtash reale po e datës 21.11.2011, ku deklarohet fakti i pagesës *cash*.

2.19 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se burimi real dhe i vetëm që ka mundësuar përfitimin e apartamentit me sip. 112.4 m² është shitja e apartamentit me sip. 69.4 m², i ndodhur në blv. “***”, Tiranë, shitur në datën 25.8.2011, për çmimin 8.948.000 lekë.

2.20 Për mosdeklarimin e faktit që apartamenti u përfitua nga shtetasi R. Sh., subjekti shpjegon se ky i fundit, duke mos pasur tagër pronësie, nuk mund të bënte shitjen e drejtpërdrejtë të apartamentit të subjekti, por ka mundësuar kryerjen e veprimit juridik, nëpërmjet aktmarrëveshjes së kalimit të të drejtave reale në datën 21.11.2011 dhe, sigurisht, kontrata e shitjes përfundimtare pas ndërtimit dhe regjistrimit të sendit do të lidhej midis shoqërisë *** sh.p.k. dhe blerësit përfundimtar Florian Bonjaku.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

2.21 Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit. Është e vërtetë që subjekti nuk ka deklaruar veprimin e kryer prej tij me shtetasin R. Sh., por ka deklaruar veprimin juridik dhe kontratën e shitjes me shoqërinë *** sh.p.k. për apartamentin me sipërfaqe 112.4 m², meqenëse dhe pronësia e këtij apartamenti ishte e shoqërisë *** sh.p.k. dhe nuk kishte kaluar ende te shtetasi R. Sh.. Nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria *** sh.p.k., si dhe nga deklarinimet e subjektit rezulton se ndërmjet shtetasit R. Sh. dhe shoqërisë *** sh.p.k. është lidhur një kontratë sipërmarrje për këtë apartament, pagesat e të cilit janë bërë nga R. Sh., ku një pjesë me marrëveshje *klering* me furnizim me çimento nga ky i fundit. Këto pagesa janë konfirmuar dhe nga bankat e nivelit të dytë, BKT dhe “Tirana Bank”. Më pas, në vitin 2011, shtetasi R. Sh. ka lidhur një marrëveshje me subjektin e rivlerësimit për shitjen e apartamentit me sip. 112.4 m², ku subjekti i ka paguar *cash* shumën 8,948,000 lekë.

2.21.1 I pyetur në seancën dëgjimore nga vëzhguesi ndërkombëtar se pse e mbajti në banesë shumën 8,948,000 lekë dhe nuk e depozitoi në banka, subjekti ka shpjeguar se i ka mbajtur për rreth 3 muaj lekët në shtëpi sepse ishte në pritje të vazhdueshme të finalizimit të kësaj

marrëdhënieje me shtetasin R. Sh. që kërkonte kryerjen e pagesës në moment (pra, me kalimin e pronësisë në emër të subjektit), i cili po vetë ishte i ndërvarur nga disponibiliteti i **shoqërisë *** sh.p.k.**

2.21.2 Edhe në aktmarrëveshjen për kalim të drejtash reale, datë 21.11.2011, lidhur ndërmjet subjektit dhe shtetasit R. Sh. është e përcaktuar se kontrata përfundimtare do të lidhet me shoqërinë *** sh.p.k., meqenëse ky shtetas ka paguar çmimin total të apartamentit kësaj shoqërie. Gjithashtu, subjekti i ka paguar çmimin total shtetasit R. Sh. dhe nuk ka detyrime financiare, për këtë apartament.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të pasurisë apartament me sip. 112.4 m², me adresë në lagjen “**”, Tiranë, në përputhje me germën “a”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

➤ **Analizë e apartamentit me sip. 69.4 m², i ndodhur në blv. “****”, Tiranë, që ka shërbyer si burim i krijimit të apartamentit me sip. 112.4 m², në lagjen “****”, Tiranë**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

2.22 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Ky apartament është blerë në datën 17.5.2004, në vlerën 19,432 USD, por realisht është prenotuar që në vitin 2003, kur ishte në fazën e ndërtimit. Ky apartament me sip. 69.4 m është blerë me lekët e marra kredi në NBG, në shumën 20,000 USD, për afat 15-vjeçar, në datën 17.5.2004. Kolateral fillimisht është lënë apartamenti me sip. 62.95 m², me adresë rr. ‘****’, Durrës. Sapo apartamenti në blv. ‘****’, Tiranë, është regjistruar në ZVRPP, është ndryshuar kolaterali i kësaj kredie dhe është vënë ky apartament si kolateral”.

2.23 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “Shitje banese me sip. 69.4 m² me adresë k. ***, blv. ‘****’, Tiranë, me nr. Pas ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, shitur me aktin noterial nr. ***, datë 25.8.2011, në shumën 9,500,000 lekë”.

2.24 Subjekti i rivlerësimit, me pyetësin nr. 1, ka depozituar kontratën e porosisë, datë 30.7.2003, me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe porosites Florian Bonjaku për ndërtimin e apartamentit në katin e ***, me sip. 72 m², me adresë blv. “****”, Tiranë, me çmimin 19,432 USD, pagesë e bërë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

2.25 Referuar deklaramit në deklaratën *Vetting*, si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer kredia në NBG, në shumën 20,000 USD. “ABI Bank”²⁶ konfirmon kredinë bankare të lidhur ndërmjet ish-bankës NBG dhe shtetasve Florian dhe S. Bonjaku në datën 13.6.2003, në shumën 20,000 USD. Nga veprimet bankare rezulton se kredia është disbursuar në datën 23.6.2003 dhe në të njëjtën datë është tërhequr *cash* shuma 19,713 USD. Kjo shumë rezulton të jetë e mjaftueshme për të mbuluar çmimin e blerjes së apartamentit në vlerën 19,432 USD.

2.26 Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të provojë me dokumentacion ligjor pagesat e kryera për blerjen e apartamentit me sip. 69.4 m², si dhe pagesën për rivlerësimin e kësaj prone.

Subjekti ka shpjeguar se për shkak të kohës së kaluar nuk disponon faturat e pagesave të apartamentit, ndërsa për pagesën e rivlerësimit ka bashkëlidhur përgjigjen e ASHK-së, datë

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2021, nga “ABI Bank”.

12.11.2021, e cila konfirmon rivlerësimin e kryer për këtë pasuri në vlerën 9,543,800 lekë, por informon se mungon mandatpagesa.

2.27 Subjekti i rivlerësimit bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e shitblerjes, datë 17.5.2004²⁷, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës Florian Bonjaku për apartamentin me sip. 69.4 m², me adresë blv. “****”, Tiranë, me çmimin 19,432 USD i likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

2.28 Me kontratën e shitblerjes, datë 25.8.2011²⁸, subjekti e ka shitur apartamentin me sip. 69.4m² blerësit I. D., me çmimin 9,500,000 lekë i paguar *cash* jashtë zyrës noteriale (në nenin 4 të kontratës citohet se është bërë rivlerësimi i kësaj prone në vlerën 9,543,800 lekë dhe në datën 24.8.2011 është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, pasi shitësi ka paguar detyrimin përkatës sipas ligjit²⁹).

Bashkëlidhur kontratës së shitjes është vërtetimi hipotekor i datës 25.8.2011, i cili konfirmon rivlerësimin e pronës në vlerën 9,543,800 lekë, me mandatarkëtimin e datës 24.8.2011.

2.29 Shuma e të ardhurave në vlerën 9,500,000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 69.4 m², datë 25.8.2011, është e mjaftueshme për të mbuluar pagesën e apartamentit me sip. 112.4 m², në vlerën 8,948,000 lekë në datën 22.11.2011.

2.30 ASHK-ja³⁰ konfirmon se apartamenti me sip. 69.4 m² ka qenë i regjistruar në emër të subjektit Florian Bonjaku dhe, më pas, i është shitur për vlerën 9,500,000 lekë, në vitin 2011, shtetasit I. D.. Në dokumentacionin e ASHK-së është dhe dokumenti i datës 1.9.2011 “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë”, ku përcaktohet se vlera në shitje e pasurisë është 69.4 m² x 88,000 lekë = 6,107,200 lekë. Vlera aktuale e shitjes 9,500,000 lekë dhe vlera e blerjes e rivlerësuar 9,543,800 lekë.

Nga dokumentacioni i disponuar rezulton se shtetasi I. D. me kontratën e shitjes, datë 9.10.2013³¹, këtë apartament ia shet shtetasit A. B. me çmimin 44,000 euro, i cili do të derdhet në llogarinë e noteres M. S.

2.31 Komisioni, me pyetësin nr. 5, ka pyetur subjektin në lidhje me shtetasin I. D., të cilit i ka shitur apartamentin me sip. 69.4 m², nëse ka pasur njohje të mëparshme dhe në vazhdimësi me këtë shtetas, nëse ka dijeni që shtetasi I. D. e ka ende në pronësi këtë apartament dhe kush ia ka prezantuar këtë shtetas.

2.31.1 Subjekti ka shpjeguar se me shtetasin I. D. i ka lidhur vetëm shitja e apartamentit me sip. 69.4 m², pasi ky ishte personi që e bleu atë. Nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie shoqërore me këtë person dhe nuk është shoqëruar asnjëherë me të. Në momentin kur subjekti ka njoftuar shitjen e apartamentit, ky person ka ardhur vetë si i interesuar për të blerë apartamentin. Nga mospasja e asnjë kontakti me këtë person, subjekti shpjegon se nuk ka dijeni se çfarë është bërë më pas me apartamentin që ka blerë prej tij.

²⁷Kontratë shitblerje nr. ***, datë 17.5.2004, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës Florian Bonjaku.

²⁸Kontratë shitblerje nr. ***, datë 25.8.2011.

²⁹Ligji nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e borxhit tatimor dhe doganor”.

³⁰ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana-Jug me shkresat nr. *** prot., datë 18.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 18.1.2022.

³¹Kontratë shitje me nr. rep. (nuk dallohet), nr. *** kol., datë 9.10.2013.

2.32 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 69.4 m², duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së të përcaktuar në Udhëzimin e vitit 2003³², i cili referon të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2003, për qytetin e Tiranës, ku përcaktohet çmimi 53,450 lekë/m², duke llogaritur 69.4 m² x 53,450 lekë/m² = 3,709,430 lekë, sipas vlerës në tregun e lirë. (19,432 USD konvertuar me kursin 106.28 lekë = 2,065,232 lekë). Konstatohet se çmimi i blerjes në kontratë me çmimin e blerjes sipas EKB-së ka një diferencë të konsiderueshme.

2.33 Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “****” sh.p.k.³³ (ish shoqëria “****” sh.p.k.), e cila ka depozituar të njëjtat kontrata me ato të depozituara nga subjekti (kontratën e porosisë datë 30.7.2003 dhe kontratën e shitblerjes datë 17.5.2004). Kjo shoqëri konfirmon se subjekti Florian Bonjaku nuk ka detyrime ndaj saj dhe nuk disponon dokumentacion shoqërues, për shkak të kohës së gjatë të kaluar.

2.33.1 Shoqëria “****” sh.p.k. ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe kontrata të tjera të lidhura në të njëjtin pallat me shtetas të ndryshëm në të njëjtën periudhë. Konkretisht: kontratën e datës 24.5.2004³⁴, për apartamentin me sip. 106.65 m², për çmimin 29,862 USD; dhe kontratën e datës 24.5.2004³⁵, për apartamentin me sip. 69.4 m², për çmimin 19,432 USD. Referuar kontratave të lartpërmendura nuk rezulton që shoqëria “****” sh.p.k. të ketë aplikuar çmim preferencial për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, duke marrë në konsideratë edhe faktin e mospasjes të ndonjë situatë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit.

2.34 Komisioni, për apartamentin me sip. 69.4 m², të ndodhur në adresën blv. “****”, Tiranë, ka konstatuar se nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja rezulton se është llogaritur vlera e këtij apartamenti në shitje [69.4 m² x 88,000 lekë/m² (çmimi referencë) në vlerën 6,107,200 lekë dhe duke e krahasuar me çmimin e pasqyruar në kontratën e shitjes prej 9,543,800 lekë, që është dhe çmimi pas rivlerësimit] rezulton të ketë një diferencë të theksuar prej 3,392,800 lekësh.

2.35 Komisioni, me pyetësin nr. 3, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë në lidhje me diferencën e theksuar në shumën 3,392,800 lekë, si pasojë e çmimit të llogaritur në treg me atë të rivlerësuar, rrethanat që kanë ndikuar në rivlerësimin e apartamentit me këtë vlerë të konsiderueshme, si dhe të depozitojë pranë Komisionit aktin e rivlerësimit që ka justifikuar rritjen e çmimit të apartamentit.

2.35.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se apartamenti është blerë në vitin 2003 dhe në këtë vit zona ka qenë e pasistemuar, ka pasur ndërtime pa leje në skarpatin e lumit afër (lumi i ***), zona ka qenë pa infrastrukturë dhe e pazhvilluar. Subjekti ka depozituar një imazh planvendosje të vitit 2003.

2.35.2 Apartamenti është shitur në vitin 2011 dhe para se ta shiste subjekti ka kryer rivlerësimin e apartamentit në bazë të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”. Rivlerësimi është bërë nëpërmjet një eksperti të

³²Udhëzimi nr. ***, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB të vlerave në tregun e lirë të banesave për vitin 2003”,

³³Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2021, e shoqërisë “****” sh.p.k.

³⁴Kontratë shitblerje nr. ***, datë 24.5.2004.

³⁵Kontratë shitblerje nr. ***, datë 24.5.2004.

licensuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, i cili ka hartuar një aktekspertim lidhur me vlerën e apartamentit, i cili është pranuar si i rregullt nga ZVRPP-ja.

2.35.3 Në vitin 2011, kur është bërë shitja e apartamentit, zona përreth tij është zhvilluar ndjeshëm. Aty janë prishur të gjitha ndërtimet pa leje, është sistemuar lumi, është gjelbëruar në të dy krahët e bulevardit, janë shtruar rrugët dhe është bërë zhvillimi i zonës. Subjekti ka depozituar një imazh planvendosje të vitit 2012.

2.35.4 Çmimi minimal i kësaj zone në vitin 2011 ka qenë në vlerën 88,000 lekë/m², i cili vlen për të gjithë zonën kadastrale, si për banesat e vjetra, ashtu edhe për të reja. Subjekti thekson se nuk kanë të njëjtën vlerë pronat buzë bulevardit me ato që janë në thellësi, si dhe ndryshon çmimi i një apartamenti të ri me një apartament parafabrikat. Apartamenti ka qenë i sistemuar, dritaret shikonin nga lulishtja anash lumit dhe ishte mjaft i mirëmbajtur. Për këtë qëllim ka qenë i nevojshëm rivlerësimi i pronës që të merrte vlerën reale. Këto kanë qenë arsyet e rivlerësimit të saj në vlerën përkatëse.

2.35.5 Lidhur me aktin e rivlerësimit të kryer për apartamentin, subjekti shpjegon se nuk e disponon si dokumentacion për shkak të kohës së kaluar. Subjekti ka depozituar përgjigjen e ASHK-së, datë 22.12.2021, e cila konfirmon se për shkak të ndryshimit të zyrave e kanë të pamundur të evidentojnë mandatpagesat dhe raportin e vlerësimit.

2.36 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me ish-shoqërinë “****” sh.p.k., sot shoqëria “****” sh.p.k. dhe administratorin/ortakët e saj: B. Sh., A. M., I. M., I. D. (i njohur ndryshe si T. B.) dhe shtetasin A. B., ku nga hetimi i kryer³⁶ nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

2.37 Komisioni ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim GJPKKO),³⁷ e cila konfirmon se kjo gjykatë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 17.2.2014, për shtetasin I. D. (quajtur ndryshe T. B.) me objekt “caktim mase sigurimi” ajo e arrestit me burg, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova që shtetasi I. D. ka kryer veprën penale “trafikim të femrave” të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal. Nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim nga personi i dyshuar I. D..

2.38 Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (PPKKKO në vijim)³⁸, e cila konfirmon se rezulton që në emër të shtetasit I. D. (T. B.), i datëlindjes 14.2.1983, të jetë regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi në datën 18.12.2015. Nga kërkimet në ish-arkivën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda deri tani nuk ka rezultuar gjetja e akteve të fashikullit të pushimit të këtij procedimi.

2.39 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

³⁶Prokuroria e Rrethit Tiranë me shkresat nr. *** prot., datë 15.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 14.2.2022; Prokuroria e Rrethit Lushnjë me shkresat nr. *** prot., datë 14.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 7.2.2022 ; Prokuroria e Rrethit Krujë me shkresat nr. *** prot., datë 18.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 7.2.2022.

³⁷Përgjigjja e GJPKKO me nr. *** prot., datë 7.2.2022.

³⁸Përgjigjja e PPKKKO nr. *** prot., datë 14.2.2022.

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar apartamentin me sip. 69.4 m² në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, vit kur është lidhur kontrata e porosisë, nuk e ka deklaruar atë në DIPP-në e vitit 2004, kur është lidhur kontrata e shitjes dhe nuk e ka deklaruar as në DIPP-të për vitet 2005 – 2010.
- b) Duket se ka dyshime për veprime fiktive, me qëllim justifikimin e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në sip. 69.4 m², nga subjekti i rivlerësimit, për arsye se:
- nuk provohet me dokument ligjor përcaktimi i vlerës së rivlerësimit në shumën 9,543,800 lekë (mungesa e aktit të rivlerësimi nga ekspertit) dhe arsyet që kanë çuar në arritjen e kësaj vlere, e cila krijon një diferencë të theksuar në vlerën 3,436,600 lekë, krahasuar me çmimin e tregut në vlerën 6,107,200 lekë (llogaritur nga ASHK-ja);
 - nuk provohet me dokument ligjor marrja e shumës 9,500,000 lekë nga subjekti;
 - shitja e apartamentit me sip. 69.4 m², në vitin 2013 (pas dy vitesh), nga blerësi I. D. në vlerën 44,000 euro ose 6,225,120 lekë (çmim i përafërt me çmimin e referencës së shitjes së apartamenteve në këtë zonë) ka një diferencë të theksuar me shitjen e vitit 2011 nga subjekti Florian Bonjaku, në vlerën 9,500,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.40 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 20.4.2022, ka shpjeguar se deklaratimet e dorëzuara në ILDKPKI-ja kanë filluar në vitin 2003 dhe në momentin fillestar është deklaruar kredia e marrë në vlerën 2,700,000 lekë, për blerje apartamenti në NBG. Në DIPP-në e vitit 2008 adresa e banimit deklarohet blv. “****”, Tiranë dhe rruga “****”. Për këtë mosdeklarim, subjekti është thirrur në ILDKPKI në vitin 2016, ku janë dhënë sqarimet në lidhje me apartamentin me sip. 69.4 m², ku është sqaruar fakti se është blerë në vitin 2003, me burim kredinë e marrë në NBG dhe nga ky institucion nuk është marrë masë apo penalizim për këtë lapsus në deklaratimet e tij dhe pasaktësia nuk ka sjellë asnjë pasojë.

2.41 Për vlerën e rivlerësimit në shumën 9,543,800 lekë, subjekti ka shpjeguar se përpara se apartamenti me sip. 69.4 m² të shitej, është bërë rivlerësimi i tij bazuar në ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” dhe është regjistruar rregullisht nga ASHK-ja Tiranë, në atë kohë ZVRPP-ja Tiranë. Rivlerësimi është bërë nga eksperti i fushës, sipas përcaktimit ligjor dhe vetëm pasi kryhej pagesa prej 1% e vlerës së marrë nga rivlerësimi të pasurisë së paluajtshme. Në mungesë të aktit të rivlerësimit i është kërkuar ASHK-së një kopje e tillë dhe nga përgjigja zyrtare e kthyer prej saj rezulton se ky akt nuk është ruajtur prej saj, por ASHK-ja thekson se kjo vlerë është e pasqyruar në kartelën e pasurisë së këtij apartamenti.

2.42 Gjithashtu, për diferencën e vlerës së rivlerësimit 9,543,800 lekë me diferencën prej 3,436,600 lekësh të krijuar nga llogaritja e çmimeve të apartamenteve në atë periudhë sipas EKB-së, subjekti ka vënë në dispozicion një aktekspertim të bërë nga një ekspert i fushës, i cili ka shpjeguar se në vitin 2011 ky apartament do të kishte vlerën 10,383,170 lekë ose 70,044 euro. Ekspertja ka shpjeguar se janë kërkesat e ligjit nr. 10148, datë 21.4.2011, i cili jep dy opsione rivlerësimi, që do të thotë se ekziston edhe një çmim tjetër në tregun e lirë të pasurive të paluajtshme, që është më i madh se çmimi minimal fiskal dhe në rastin konkret, çmimi për metër katror i shitjes në tregun e lirë të pasurive të paluajtshme të llojit apartament, në bllokun

e banimit ku gjendet objekti i vlerësimit, rezultoi se është 150.045,77 lekë/m² ose 1.070 euro/m².

Subjekti shpjegon se çmimi i rivlerësimit prej 9,500,000 lekësh është çmim në përputhje me vlerat e shitjes së apartamenteve të tjera në atë zonë. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka paraqitur në cilësinë e provës në Komision kopje të botimeve të gazetës “****”, për vitet 2010-2011, ku pasqyrohen çmimet e apartamenteve bazuar në ofertat për shitje dhe kërkesat për blerje në atë kohë, në po të njëjtën zonë, ndër të tjera, si vijon: apartament me sip. 75 m², mars 2010, çmimi 67,000 euro (893,3 euro/m²); apartament me sip. 70 m², shkurt 2010, çmimi 90,000 euro (1285,7 euro/m²); apartament me sip. 59 m², maj 2011, çmimi 55,000 euro (932,2 euro/m²); apartament me sip. 87 m², prill 2011, çmimi 73,000 euro (839,1 euro/m²); etj. Kopjet e botimeve të gazetës “****”, të viteve 2010 – 2012, rezultojnë të tërhequra zyrtarisht nga Biblioteka Kombëtare dhe në to reflektohen çmime të shitjes së apartamenteve në zonën ku ndodhej edhe apartamenti me sip. 69.4 m², çmime këto të përafërta ose edhe më të larta se çmimi i shitjes së apartamentit prej subjektit, në vlerën 9,500,000 lekë.

2.43 Për shitjen e apartamentit, dy vjet më pas, në vitin 2013, nga blerësi I. D., shtetasit A. B., me çmimin 44,000 euro, me një diferencë të theksuar krahasuar me çmimin e shitjes së apartamentit nga Florian Bonjaku, në vitin 2011, në vlerën 9,500,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se nuk ka informacion se përse është bërë një shitje e tillë, duke hamendësuar se mund të ketë qenë nevoja/arsye specifike për likuiditete. Subjekti nuk ka pasur kontakte dhe njohje me këtë të fundit, por pas kërkimeve ka arritur të kontaktojë shtetasin A. B. personin që bleu apartamentin nga shtetasi I. D.. Pronari i fundit, shtetasi A. B. ka lëshuar deklaratën noteriale, datë 24.3.2022, në të cilën deklaron se shtetasi I. D., për shkak të nevojës urgjente për t’u larguar jashtë shtetit, kishte nxjerrë në shitje këtë apartament me çmimin 44,000 euro. Subjekti shpjegon se shtetasi A. B. është i gatshëm të paraqitet në çdo moment për të dëshmuar kudo për këtë fakt. Subjekti, për këtë shpjegim, ka depozituar me cilësinë e provës deklaratën noteriale të datës 24.3.2022³⁹ të deklaruesit A. B..

Rihetimi nga Komisioni

2.44 Komisioni, në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit me sip. 69.4 m², në vlerën 9,500,000 lekë, pas seancës dëgjimore të datës 20.4.2022, ka njoftuar subjektin se ka vendosur të bëjë disa hetime shtesë në lidhje me çmimin e shitjes së këtij apartamenti.

2.45 Për këtë qëllim është administruar përgjigjja e ASHK-së Tiranë⁴⁰, e cila ka vënë në dispozicion të Komisionit kontrata shitje të apartamenteve në pallatin ku ndodhet edhe apartamenti me sip. 69.4 m², si dhe kontrata të pallatit ngjitur me të, të ndërtuara thuajse në të njëjtën periudhë kohore dhe konkretisht: apartament me sip. 97.90 m², viti 2012, çmimi 75,000 euro; apartament me sip. 97.9 m², viti 2008, çmimi 60,000 euro; apartament me sip. 121.10 m², viti 2011, çmimi 14,500,000 lekë; apartament me sip. 101.5 m², viti 2011, çmimi 8,932,000 lekë; apartament me sip. 106.2 m², viti 2010, çmimi 8,700,000 lekë; si dhe apartament me sip. 121.1m², viti 2010, çmimi 6,177,000 lekë.

2.46 Në lidhje me këtë situatë të re, pas informacionit dhe dokumentacionit të siguruar nga ASHK-Tirana Jug, subjekti, në prapësimet shtesë dhe në seancën dëgjimore të datës 27.5.2022,

³⁹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.3.2022, depozituar nga subjekti me prapësimet e para.

⁴⁰Shkresat nr. *** prot., datë 27.4.2022 dhe nr. *** prot., datë 9.5.2022, nga ASHK-ja Tirana Jug.

ka shpjeguar edhe një herë se çmimi i shitjes së apartamentit në pronësi të tij në vlerën 9,500,000 lekë, është një çmim real bazuar në pozicionin gjeografik të apartamentit dhe të vetë pallatit buzë bulevardit, zhvillimin infrastrukturor që ka marrë zona falë investimeve të kryera, si dhe çmimeve të tregut të aplikuara në këtë zonë. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe kontrata shitje të apartamenteve të ndodhura, pikërisht, në zonën ku ndodhet apartamenti me sip. 69.4 m², ku nga çmimet e shitjes të pasqyruara në këto kontrata reflektohet qartë se vlera e apartamenteve ka qenë dhe më e lartë se sa çmimi i shitjes së apartamentit të subjektit. Më konkretisht, subjekti ka referuar kontratat e disponuara nga ASHK-ja, ku rezultojnë se janë shitur apartamente në atë zonë me çmime respektive: apartament me sip. 46 m², kontrata e vitit 2000, shitur me çmimin 9,500,000 lekë (206,521 lekë/m²); apartament me sip. 58 m², kontrata e vitit 2012, shitur me çmimin 9,674,400 lekë (166,800 lekë/m²); apartament 69.1 m², kontrata e vitit 2012, shitur me çmimin 9,660,000 lekë (139,797 lekë/m²); apartament 88.1 m², kontrata e vitit 2011, shitur me çmimin 85,000 euro (964,81 euro/m²); apartament me sip. 73 m², kontrata e vitit 2007, shitur me çmimin 14,145,000 lekë (193,767 lekë/m²); apartament me sip. 105.14 m², kontrata e vitit 2008, shitur me çmimin 16,250,400 lekë (154,560 lekë/m²); apartament me sip. 79.3 m², kontrata e vitit 2011, shitur me çmimin 11,523,000 lekë (145,309 lekë/m²).

Gjithashtu, subjekti paraqiti edhe grafikisht largësinë midis vendndodhjes së apartamentit të tij me apartamentet e tjera të referuara si më lart. Subjekti thekson se vlerat e apartamenteve të shitura në atë kohë kanë vlerë të përafërt, madje disa edhe vlera më të larta se çmimi i shitjes së apartamentit të subjektit me sip. 69.4 m², pra, është pikërisht ai çmimi real i shitjes, duke mos pasur asnjë dyshim për elementë të fiktivitetit mbi çmimin e aplikuar.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

2.47 Në lidhje me mosdeklarimin e apartamentit me sip. 69.4 m² në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe 2004, që korrespondon përkatësisht me kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe atë të shitblerjes së këtij apartamenti, si dhe mosdeklarimin e tij deri në vitin 2010, Komisioni mban në konsideratë faktin se deklarata *Vetting* është dokumenti ligjor bazë, në të cilën Komisioni bazon procesin e rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë. Në këtë deklaratë, ligji i ka dhënë të drejtën subjekteve të rivlerësimit që përveç deklarimit me saktësi të pasurive aktive, ata të deklarojnë, rregullojnë dhe të sistemojnë me korrektesë dhe vërtetësi, pasuri që kanë lidhje me pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të cilat mund të mos jenë deklaruar apo janë deklaruar me të meta ndër vite.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë shitjen e këtij apartamenti dhe vlerën e përfituar nga shitja, në DIPP-në e vitit 2011.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi në deklaratën *Vetting* historikun e krijimit të kësaj pasurie që në vitin 2003, si dhe faktin se shuma e përfituar nga shitja e këtij apartamenti ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ri në rrugën “***”, në vitin 2011.

Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i pasurisë apartament, me sip. 69.4 m², në deklaratat e pasurisë të vitit 2003, 2004, të konsiderohet si një pasaktësi në deklaram, e cila e parë ndërthurur me deklarimin e shitjes së këtij apartamenti në DIPP-në e vitit 2011, me deklarimin me vërtetësi të historikut të këtij apartamenti, si dhe të destinacionit të shumës së

përfituar nga shitja e tij, në deklaratën *Vetting*, merr një peshë minimale, jo deri në atë masë sa që të mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit për sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë.

2.48. Në lidhje me dyshimet e ngritura për caktimin e çmimit fiktiv në vlerën 9,500,000 lekë ose 136,888 lekë/m², në kontratën e shitblerjes së apartamentit me sip. 69.4 m², në vitin 2011, Komisioni, pas hetimit të kryer dhe provave të siguruara, si dhe pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe vlerësoi provat e paraqitura prej tij, çmon se:

2.48.1 Gazeta “****” ka qenë një gazetë me tirazh kombëtar, ku individë apo subjekte të ndryshme njoftonin shitjen apo blerjen e pasurive të paluajtshme, të luajtshme, të automjeteve, makinerive apo edhe bizneseve të ndryshme. Specifikisht në të botoheshin masivisht, njoftime për shitje apo blerje pasurish të paluajtshme nga individë apo edhe shoqëri ndërtuese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar edhe çmimet përkatëse. Për rrjedhojë, gazeta “****” ka shërbyer si një agjenci e mirëfilltë shitblerjesh pasurish të paluajtshme, duke u konsideruar kështu si një indikator i besueshëm në lidhje me çmimet e tregut për pasuritë e paluajtshme dhe jo vetëm.

Pavarësisht se ajo mund të mos konsiderohet si një provë shteruese dhe e pakundërshtueshme, për arsye se çmimi përfundimtar i shitblerjes së një pasurie të paluajtshme përcaktohet vetëm në kontratën e shitblerjes, përsëri ajo konsiderohet si një provë e besueshme për vetë faktin se është depozituar në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit si një dokument i nxjerrë nga një institucion shtetëror siç është Biblioteka Kombëtare dhe, përveç kësaj, botimi në të i një numri të konsiderueshëm njoftimesh për shitje apo blerje pasurish, të krijon bindjen se çmimet e pasqyruara në këto njoftime edhe po të mos ishin çmimet reale të shitblerjes së tyre, absolutisht që ishin çmime të përafërta me çmimet e tregut, në lidhje me shitblerjen e pasurive të paluajtshme.

Komisioni, marrë për bazë shpjegimet e subjektit, si dhe nga verifikimet e kryera, konstaton se në këtë gazetë, në të njëjtën periudhë kohore me shitjen e apartamentit prej subjektit dhe në të njëjtën zonë që përfshin zonën e blv. “****” dhe atë të rrugës “****”, rezultojnë të jenë njoftuar për shitje apartamente me çmim të përafërt apo edhe më të madh se çmimi i përcaktuar nga subjekti në kontratën e shitblerjes, deri në 1285,7 euro/m², çka krijon bindjen se çmimi i shitjes së apartamentit nga subjekti në vlerën 9,500,000 lekë, në vitin 2001, është çmim real i përafërt me çmimet e tregut në të njëjtën zonë dhe në të njëjtën kohë.

2.48.2 Nga korrespondenca që Komisioni kreu me ASHK-në Tiranë, u vunë në dispozicion të Komisionit 6 (gjashtë) kontrata shitblerje apartamentesh në pallatin ku ka pasur apartamentin subjekti, si dhe në pallatin ngjitur nga ku rezultuan çmime relativisht më të ulëta shitjesh se ai i subjektit, por këtu duhet të mbajmë në konsideratë faktin se ka edhe kontrata shitjesh direkt nga subjekti ndërtues te porositësi të cilat dihet që pasqyrojnë një çmim më të ulët sesa në rastet kur transaksioni kryhet ndërmjet individëve. Sidoqoftë, në njëërën prej kontratave të shitjes për apartamentin me sip. 121.10 m², viti 2011, është aplikuar çmimi i shitjes prej 14,500,000 lekësh ose rreth 120,000 lekë/m², çmim ky i përafërt me çmimin e shitjes të aplikuar nga subjekti prej 136,888 lekë/m², çka përsëri përforcon bindjen se çmimi i shitjes së apartamentit i aplikuar nga subjekti i rivlerësimit është çmimi real i tregut.

2.48.3 Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit kontrata shitblerje apartamentesh në të njëjtën zonë me atë të apartamentit në pronësi të subjektit dhe në të njëjtën periudhë kohore, nga ku rezultojnë çmime shitjeje kryesisht më të larta se ato të aplikuar nga subjekti që variojnë nga 139,797 lekë/m² deri në 206,521 lekë/m² (shihni pikën 2.45), çka përsëri përforcon bindjen se çmimi i shitjes së apartamentit i aplikuar nga subjekti i rivlerësimit është çmimi i tregut.

2.48.4 Në aktin e ekspertimit të përgatitur nga një ekspert vlerësues i pasurive të paluajtshme, në vitin 2011, përpara shitjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, dokument ky ligjor, i përgatitur në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” dhe i regjistruar në ish-ZVRPP-në Tiranë, është arritur në përfundimin se çmimi për metër katror i shitjes në tregun e lirë të pasurive të paluajtshme të kësaj pasurie të llojit apartament, në bllokun e banimit ku gjendet objekti i vlerësimit, rezulton të jetë në vlerën 150.045,77 lekë/m² ose 1.070 euro/m², çka përsëri përforcon bindjen se çmimi i shitjes së apartamentit i aplikuar nga subjekti i rivlerësimit është çmimi i tregut.

2.48.5 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion të Komisionit edhe imazhe planvendosje të vitit 2003, kur është porositur blerja e apartamentit dhe të vitit 2012, një vit pas shitjes së tij, nga ku konstatohet një ndryshim rrënjësor i komplet infrastrukturës së zonës ku ndodhet ky apartament, çka pasqyrohet në rritjen e çmimeve të pasurive të paluajtshme në zonë.

2.48.6 Në lidhje me blerësin e këtij apartamenti, z. I. D. (T. B.), nga hetimi i kryer, Komisioni nuk arriti të provojë që ndërmjet këtij shtetasi dhe subjektit të ketë pasur njohje të mëparshme apo në vazhdimësi, shoqëri të vazhdueshme apo marrëdhënie interesi në vazhdimësi, situata këto që Komisioni do të mund t'i merrte në konsideratë në lidhje mundësinë e ndonjë dakordësie mes palëve në kontratë, për caktimin e një çmimi fiktiv të ndryshëm nga ai që mund të jetë paguar në të vërtetë, me vlerësimin e figurës, si dhe të etikës së subjektit të rivlerësimit, në kuadër të cenimit të besimit të publikut të drejtësia.

2.48.7 Në lidhje me çmimin e shitjes së këtij apartamenti nga shitësi I. D. te blerësi A. B., për vlerën 44,000 euro, në vitin 2013, me një diferencë të theksuar krahasuar me çmimin e shitjes së apartamentit nga Florian Bonjaku, në vitin 2011, për vlerën 9,500,000 lekë, Komisioni i vlerëson të mjaftueshme shpjegimet e subjektit, si dhe ato të dhëna nga blerësi A. B. në deklaratën noteriale të datës 24.3.2022, çka konsiston në shitjen e apartamentit me çmim të favorshëm, për shkak të nevojës urgjente të shitjes së tij nga ana e pronarit I. D., për shkak të largimit jashtë shtetit.

Në përfundim, Komisioni, pasi mori në konsideratë dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si edhe provat e siguruar nga Komisioni, arrin në përfundimin se çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 96.4 m², në vitin 2011, për vlerën 9,500,000 lekë, nga subjekti i rivlerësimit nuk është një çmim fiktiv i paracaktuar nga subjekti i rivlerësimit dhe e blerësit, por një çmim shitje real i diktuar nga çmimet e tregut të shitblerjes së pasurive të paluajtshme në po atë zonë.

3. Automjet tip “**”, me targa ***, me vlerë 220,000 lekë**

3.1 Pasuria automjet tip “****”, me targa ***, blerë në shumën 220,000 lekë, më 24.1.2017⁴¹. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten. Burimi i krijimit: kursime nga pagat.

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.2 Nga korrespondenca e kryer nga Komisioni, DPSHTRR-ja⁴² konfirmon se automjeti tip “****” i vitit 2007, me targa ***, figuron i regjistruar në emër të shtetasve Florian dhe S. Bonjaku, blerë me kontratën e shitblerjes datë 23.1.2017⁴³ për çmimin 220,000 lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, me shitës shtetasin A. N.⁴⁴.

3.3 Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. N., por nga hetimi nuk ka rezultuar një situatë e tillë⁴⁵.

Analizë e burimit të krijimit

3.4 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti, nga leximi i DIPP-së së vitit 2016 rezulton se subjekti ka deklaruar shtesë kursimesh në shumën 290,000 lekë, e cila është e mjaftueshme për të kryer pagesën për blerjen e automjetit në datën 23.1.2017.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me deklarin e subjektit dhe vlerën e blerjes së këtij automjeti.

4. Kredi në shumën 20,000 USD, për blerje apartamenti, në NBG

4.1 Kredia në shumën 20,000 USD është marrë me kontratën e kredisë nr. ***, datë 13.6.2003, me afat 15-vjeçar, me interes 5.9%, me këst vlerën 180 USD/muaj. Kredia është shlyer përpara afatit të saj më 22.4.2011, ku është paguar për shlyerjen e saj shuma 12,549 USD. Detyrimi 0 (zero) dollarë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.2 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Burim për shlyerjen e kësaj kredie ka qenë: (i) një kredi bankare e marrë në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 8.4.2011, në shumën 1,020,000 lekë, me afat 5-vjeçar; dhe (ii) lekët e tërhequra nga ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në datën 22.4.2011, që e kishin burimin nga pagesa ime si pedagog i jashtëm në universitetin ‘****’.*”

4.3 “ABI Bank”⁴⁶ konfirmon kredinë bankare të lidhur ndërmjet ish-bankës NBG Albania dhe shtetasve Florian dhe S. Bonjaku në datën 13.6.2003, në shumën 20,000 USD dhe dokumentacionin përkatës^{47/48/49}.

⁴¹Sipas kontratës nr. ***, datë 23.1.2017.

⁴²DPSHTRR-ja me nr. *** prot., datë 7.2.2020.

⁴³Kontrata e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 23.1.2017.

⁴⁴Ky automjet është blerë nga shtetasi A. N. në shtetin francez për shumën 1,500 euro më 6.3.2015. Nga dokumenti doganor rezulton se më 8.3.2015, shtetasi A. N. ka paguar taksën doganore në shumën 46,458 lekë. Në total, automjeti ka kushtuar 256,458 lekë (llogaritur 1,500 euro x 140 lekë/euro kursi ditë = 210,000 lekë + 46,458 lekë dogana = 256,458 lekë).

⁴⁵Për këtë qëllim ka administruar përgjigjet e Prokurorive të Rrethit Tiranë, Lushnje dhe Krujë, të cilat kanë konfirmuar që nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar kallëzim apo procedim penal për këtë shtetas.

⁴⁶Shkresë me nr. *** prot., datë 6.10.2021, nga “ABI Bank”.

⁴⁷Kontratë kredie dhe vënie në hipotekë e pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 13.6.2003.

⁴⁸Kontratë hipoteke nr. ***, datë 24.6.2005.

⁴⁹Vërtetim hipotekor për apartamentin e ndodhur në z. k. *** me sip. 69.4 m², blv. “****”, në emër të subjektit.

4.4 Subjekti, kredinë e ka deklaruar periodikisht, ndërsa në DIPP-në e vitit 2011 deklaroi pagesën përfundimtare të kredisë në NBG, kredi e marrë për blerje apartament banimi në datën 22.4.2011, paguar vlera 12,548 USD.

Analizë e burimit të shumës së përdorur për shlyerje të parakohshme të kredisë

4.5 Në datën 22.4.2011, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogari bankare shumën 12,984 USD ose kundërvleftën në shumën 1,262,304 lekë⁵⁰. Subjekti ka deklaruar si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë në NBG, kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën 1,020,000 lekë, në datën 8.4.2011 dhe shumën e tërhequr në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 22.4.2011.

“Raiffeisen Bank”⁵¹ konfirmon kredinë konsumatore të marrë nga subjekti në shumën 1,020,000 lekë. Kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 11.4.2011 dhe është tërhequr *cash* prej tij në datën 22.4.2011. “Intesa Sanpaolo Bank”⁵² konfirmon tërheqjen e datës 22.4.2011, në shumën 2,500 euro (konvertuar në vlerën 353,925 lekë⁵³) nga subjekti. Kjo shumë është krijuar nga pagesat e kryera nga universiteti “****” si honorare për punën e tij si pedagog i jashtëm.

Të ardhurat e përfituara në bankë nga pagesat e kryera nga universiteti “****” si honorare për punën e tij si pedagog i jashtëm nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi nuk provohet lloji i marrëdhënies së punësimit/shërbimit dhe pagesa e detyrimeve tatimore.

Duket se subjekti i rivlerësimit, për të paguar vlerën 12,984 USD ose kundërvleftën në shumën 1,262,304 lekë, ka pasur në dispozicion shumën 1,020,000 lekë me burim kredinë dhe shumën 2,500 euro ose 353,925 lekë me burim të ardhurat nga puna si pedagog i jashtëm.

4.6 Komisioni vëren se për sa u analizua më sipër, të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës D, të nenit 3, të Aneksit të Kushtetutës janë vetëm të ardhurat nga kredia në shumën 1,020,000 lekë, duke rezultuar në këtë mënyrë me mungesë burimesh në shumën 240,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se të ardhurat nga mësimdhënia pranë universitetit “****” duhet të konsiderohen si burim i ligjshëm, pasi provohet plotësisht të jenë paguar nëpërmjet sistemit bankar përgjatë viteve 2009 - 2010, me përshkrimin konkret “honorare nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm tek universiteti “****”. Ndodhur në kushtet e pamundësisë për të marrë akte provuese nga universiteti “****” për shkak të heqjes së licencës me VKM-në nr. 539, datë 6.8.2014, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 18.3.2022, të ish-dekanit të Fakultetit të *** në universitetin “****”, prof. as. A. Ll., që konfirmon se shtetasi Florian Bonjaku ka qenë pedagog pranë këtij universiteti dhe pagesat ndaj tij janë kryer nëpërmjet sistemit bankar.

Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore subjekti ka depozituar edhe një përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila konfirmon se për pagesa të tjera që lidhen me të

⁵⁰Vlera 12,984 USD me kursin e këmbimit të dollarit 97.22, të datës 22.4.2011 sipas Bankës së Shqipërisë.

⁵¹Shkresë me nr. *** prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

⁵²Shkresë me nr. *** prot., datë 17.2.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁵³Konvertuar me kursin e këmbimit të euros 141.57 të datës 22.4.2011, sipas Bankës së Shqipërisë.

ardhurat e listuara në germat “b” deri në “g” të nenit 8, paguesi i të ardhurave mban në burim tatimin në masën 15% të pagesës dhe e derdh në organin tatimor përkatës brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

4.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me përfitimin e të ardhurave nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në universitetin “****”. Komisioni, në tërësi të rrethanave dhe fakteve, për sa kohë që provohet përfitimi i të ardhurave nga mësimdhënia në universitetin “****” nëpërmjet depozitimit ose transferimit të honorareve nga universiteti në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar faktit se institucioni i arsimit të lartë ka qenë person juridik dhe në momentin e kryerjes së pagesës ai ka pasur edhe detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat, nuk e ngarkon subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi sipas ligjit nr. 84/2016. Për aq kohë sa të ardhurat nga mësimdhënia janë deklaruar rregullisht në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike dhe provohet se ekzistojnë dhe vijnë pikërisht nga burimi i deklaruar si i tillë nga subjekti (mësimdhënia), si dhe provohet përdorimi i tyre sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit, mungesa e provueshmërisë për pagimin e tatimit i përket një subjekti tjetër dhe se subjekti është në pamundësi objektive për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore, pasi institucioni i arsimit të lartë tashmë nuk ekziston. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi si të drejta shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe i mori në konsideratë në analizën financiare të ardhurave nga mësimdhënia. Komisioni mori në konsideratë edhe praktikën e ndjekur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁵⁴ lidhur me mosngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit për pagesën e detyrimeve tatimore në rastin kur pagesa e saj ka qenë detyrim i personit juridik me të cilin subjekti i rivlerësimit është futur në marrëdhënie kontraktuale.

Komisioni përfshiu në analizën financiare të rishikuar të ardhurave nga mësimdhënia, duke i konsideruar si burim të ligjshëm për shlyerjen e kredisë para afatit të caktuar.

5. Kredi bankare (konsumatore) për shumën 1,020,000 lekë, në “Raiffeisen Bank”

5.1 Kredia në shumën 1,020,000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, është marrë me kontratën e datës 8.4.2011, me afat 60 muaj, me interes 9.6%, me kështë vlerën 24,451 lekë/muaj, mbyllur në maj të vitit 2016. Detyrimi 0 (zero) lekë.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

5.2 Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2011. Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar edhe kontratën e kredisë bankare datë 8.4.2011 me kredidhënës “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrës Florian dhe S. Bonjaku për kredinë në shumën 1,020,000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi i tyre për arsye personale, me afat 60 muaj.

5.3 “Raiffeisen Bank”⁵⁵ konfirmon kredinë bankare të marrë nga subjekti në datën 8.4.2011, disbursuar në llogarinë e tij në datën 11.4.2011 dhe të likuiduar prej tij sipas afatit deri më 11.4.2016.

⁵⁴Vendimet nr. 14/2021 (JR) datë 15.6.2021; nr. 15/2021 (JR), datë 18.6.2021; dhe nr. 6/200 (JR), datë 17.3.2022.

⁵⁵Shkresë me nr. *** prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

5.4 Komisioni, në pikën 4.4, ka analizuar destinacionin e përdorimit të kësaj kredie, destinacion që përputhet me qëllimin e marrjes së kredisë bankare.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë kredi.

6. Kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse (overdraft) në shumën 80,000 lekë, marrë më 16.5.2011, me interes 10.1%/vit. Detyrimi 0 (zero) lekë.

6.1 Subjekti ka depozituar kontratën e huas datë 16.5.2011, lidhur me huadhënësin “Raiffeisen Bank” dhe huamarrës Florian Bonjaku për dhënien e huas deri në shumën 80,000 lekë.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me overdraftin e marrë në “Raiffeisen Bank”.

KONSTATIME TË TJERA

7. Apartament me sip. 73 m², me vlerë 3,200,000 lekë, Durrës

7.1 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi, ndërtuar përpara vitit 1990, me sip. 73 m², me vlerë 3,200,000 lekë, ndodhur në Lagjen ***, p. ***, rruga “***”, Durrës. Pjesa takuese: 1/4. Burimi i krijimit: nga privatizimi i banesave*”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 deklaroi: “*Pakësuar, shitur shtëpi banimi në Durrës 1+1 me bashkëpronësi me prindërit në vlerën 30,000,000 lekë (shkruar dhe me fjalë, tridhjetë milionë lekë). Pjesa takuese: 1/3*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.2 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 1, ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 3.2.1994, me shitës Ndërmarrje Komunale Banesa Durrës dhe blerës A., S. dhe Florian Bonjaku për blerjen e apartamentit në çmimin 8,729 lekë, me sip. 56.6 m², p. ***, ap. ***, k.***, rruga “***”, Durrës.

7.3 ILDKPKI-ja⁵⁶ ka përcjellë në Komision kontratën e shitjes së apartamentit të mësipërm, datë 8.11.2006⁵⁷, me shitës A. dhe S. Bonjaku dhe blerës Sh. H. etj., përkundrejt çmimit 200,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

7.4 Në procesverbalin e datës 3.4.2012 të mbajtur në ILDKPKI subjekti deklaroi: “*Saktësoj se apartamenti në Durrës është përfutur nga procesi i privatizimit prej prindërve të mi. Për shkak të shitjes së këtij apartamenti në vitin 2006, prej prindërve të mi unë kam hequr dorë nga pjesa takuese mbi këtë apartament dhe veprimet e tjetërsimit i kanë kryer prindërit e mi. Nga kjo shitje unë nuk kam përfutur asnjë të ardhur*”.

7.5 Nga sistemi EPS i ASHK-së është administruar dokumentacioni i apartamentit me sip. 56.6 m², ku rezultoi se, fillimisht, është përfutur me kontratën e datës 3.2.1994, me shitës NK Banesa Durrës dhe blerës A., S. dhe Florian Bonjaku, me vlerën 8,729 lekë. Me kontratën e shitblerjes datë 8.11.2006⁵⁸, shtetasit A. dhe S. Bonjaku ia shesin apartamentin shtetasit Sh. H. etj., për çmimin 200,000 lekë.

⁵⁶Përgjigjja nr. *** prot., datë 11.2.2020, e ILDKPKI-së.

⁵⁷Kontrata e shitjes nr. ***, datë 8.11.2006.

⁵⁸Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 8.11.2006.

7.6 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 29.1.2016, kur është pyetur për deklarimin e shitjes së këtij apartamenti në Durrës në bashkëpronësi me prindërit në vlerën 3,000,000 lekë në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 8.11.2006, e cila pasqyron çmimin 200,000 lekë, ku deklaroi se: “*Kam deklaruar vlerën e cila më është thënë nga prindërit e mi*”.

7.7 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit në rrugën “****” (apartamenti i prindërve), ku në DIPP-në e vitit 2006 deklaroi shumën 3,000,000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes së datës 8.11.2006 pasqyrohet vlera 200,000 lekë.

Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerësoi të mos i kalojë subjektit barrë prove në lidhje me këtë pasuri për sa kohë që nuk ka pretenduar përfitim të ardhurash nga shitja e këtij apartamenti dhe, për rrjedhojë, kjo pasuri konsiderohet pa impakt financiar në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

8. Kursime *cash*, gjendje në datën 31.12.2016

8.1 Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI dhe në përgjigjet e dhëna prej tij në pyetësin nr. 2, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash*, ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016, në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë në deklaratën *Vetting*.

8.2 Komisioni, referuar deklaratimeve periodike dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me ecurinë e gjendjes *cash* në pyetësin nr. 2, ka pasqyruar ecurinë e gjendjes *cash*, ndër vite, duke përfshirë në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016 gjendjet *cash*, si në vijim.

Gjendja e kursimeve *cash* në datën 31.12.2003 është në shumën 400,000 lekë. Kjo gjendje mbartet e pandryshuar deri në vitin 2005. Në vitin 2006, subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve me vlerë 450,000 lekë, nga ku rezulton se gjendja *cash* në datën 31.12.2006 është në shumën 850,000 lekë. Kjo gjendje *cash* vazhdon me këtë balancë deri në datën 31.12.2009. Për vitin 2010, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në formën e shtesave/pakësimeve, por ka deklaruar kursime në vlerën 200,000 lekë dhe deri në vitin 2013 subjekti nuk ka kryer deklarime në DIPP-të përkatëse për likuiditetet *cash*. Në vitin 2014 subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve në shumën 240,000 lekë, nga ku gjendja në datën 31.12.2014 rezulton të jetë në shumën 440,000 lekë. Në vitin 2015, subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve në shumën 150,000 lekë, duke akumuluar në datën 31.12.2015 gjendje në shumën 590,000 lekë. Edhe për vitin 2016 subjekti ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë shtesë në likuiditetet *cash* në shumën 290,000 lekë, duke rezultuar në datën 31.12.2016 me një gjendje *cash* në shumën 880,000 lekë.

8.3 Sipas analizës së kryer nga Komisioni rezulton se gjendja *cash* në datën 31.12.2016 është në shumën 880,000 lekë. Kjo shumë është pakësuar në datën 23.1.2017 për vlerën 220,000 lekë për blerjen e automjetit dhe në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* (25.1.2017) subjekti ka pasur gjendje *cash* shumën 660,000 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën *Vetting*.

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me gjendjen *cash* sepse sipas analizës së Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur *cash* shumën 660,000 lekë, gjendje në datën 25.1.2017, ndërsa sipas deklaramit është pasqyruar gjendja 0 (zero) lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se gjendjet *cash* deri në vitin 2006 të paraqitura nga Komisioni janë të sakta. Për vitin 2006 subjekti shpjegon se meqenëse gjendja *cash* në banesë nuk është e njëjtë si në vitin 2005, subjekti ka deklaruar shumën 450,000 lekë dhe pretendon se kjo është gjendja në datën 31.12.2006 dhe jo shtesa e kursimeve për vitin 2006. Për vitet 2007, 2008 dhe 2009, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në vlerat monetare gjendje *cash* në banesë sepse nuk ka pasur ndryshime. Për vitin 2010, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 200,000 lekë dhe meqenëse për vitet 2011, 2012 dhe 2013 nuk ka deklaruar ndryshime në vlerat monetare gjendje *cash* në banesë është sa në vitin 2010. Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është po e njëjta situatë si në vitin 2006, që nënkupton se subjekti në datën 31 dhjetor të çdo viti ka pasur gjendje *cash* në banesë shumat e deklaruara në deklaratat periodike përkatëse.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

8.5 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni në lidhje me deklaramin e gjendjeve *cash*. Subjekti, edhe pse deklaron në mënyrë të qartë dhe të plotë në DIPP shtesat, duke nënkuptuar se logjika e deklarameve të kryera prej tij i referohet ndryshimeve të gjendjes *cash* nga njëri deklaram në tjetrin dhe jo gjendjes, ka pretenduar në shpjegime se shumat e deklaruara janë gjendje në datën 31 dhjetor dhe jo shtesa të vitit përkatës.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaramet e tij periodike me përjashtim të viteve 2003 dhe 2006, në deklaramet e tij për likuiditetet *cash* ka përdorur fjalën “shtuar”, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë mënyrës së deklaramit, ku detyrimi ligjor është deklarami i ndryshimeve të ndodhura në vitin për të cilin plotësohet deklarata e interesave private periodike.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të gjendjes *cash* në deklaramtën *Vetting*, por kjo pasaktësi, duke marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, nuk vlerësohet se arrin deri në atë masë sa ndaj tij të aplikohet masa disiplinore në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

9. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

9.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se nga analiza e deklaramave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaramtës *Vetting*, për periudhën e hetimit 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumën totale prej **869,495 lekësh**.

9.2 Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar pasaktësinë në deklaram, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni për elementët e mëposhtëm:

- gjendja *cash*, e përfshirë në analizën financiare, duhet pasqyruar sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti ku shumat e deklaruara prej tij duhen konsideruar si gjendje likuiditetesh dhe jo si shtesa dhe pakësime;
- të ardhurat si pedagog i jashtëm në universitetet “****” dhe “****” gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2013 duhet të merren në konsideratë, pasi janë të ardhura të deklaruara dhe likuidimet janë bërë nëpërmjet sistemit bankar dhe detyrimi i pagesës së tatimit nuk ka qenë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit;
- shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten në vlerat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe jo sipas përlllogaritjes së Komisionit;
- në vitin 2003 nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit asnjë shpenzim në lidhje me apartamentin e banimit me sip. 75 m², me kontratë datë 8.3.2003;
- shpenzimet jetike për periudhën 2009 – 2016 janë në shumën 6,350,000 lekë dhe jo 4,945,964 lekë sipas përlllogaritjeve të Komisionit.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

9.4 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me pretendimin e tij për pasqyrimin e gjendjes *cash* sipas shpjegimeve të dhëna prej tij në pyetësorë. Komisioni ka arsyetuar më gjerësisht në pikën 8.5 të vendimit për këtë pretendim dhe nuk e ka marrë atë në konsideratë në analizën financiare.

9.4.1 Në lidhje me të ardhurat si pedagog i jashtëm, Komisioni si ka arsyetuar edhe në pikën 4.8 të vendimit, i gjeti pretendimet e subjektit të drejta dhe, për këtë arsye, i mori ato në konsideratë në analizën financiare të rishikuar.

9.4.2 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokumentacion ligjor mbi të cilin të mbështesë deklaratimet e tij për vlerat e pretenduara dhe, për këtë arsye, Komisioni nuk i mori ato në konsideratë.

9.4.3 Së fundmi, Komisioni, ashtu si ka vlerësuar edhe në pikën 1.13 të vendimit kur ka konkluduar se kontrata e lidhur me prindërit e bashkëshortit, ashtu si është deklaruar edhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*, është lidhur me qëllimin e vetëm për marrjen e kredisë dhe se subjekti nuk ka kryer pagesën prej 10,000 USD apo ekuivalencën e saj në shumën 1,086,900 lekë, nuk e mori në konsideratë në analizë financiare këtë shumë si të paguar nga subjekti.

9.5 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në konsideratë sa më lartarsyetuar, kreu analizën financiare të rishikuar për subjektin e rivlerësimit, pas prapësimeve dhe seancës dëgjimore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 407,722 lekë.

9.6 Në bazë të parimit të proporcionalitetit, kjo balancë negative vlerësohet me një peshë minimale dhe nuk mund të ndikojë deri në atë masë sa që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për deklaram të pamjaftueshëm, bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se pasaktësitë e konstatuara, si dhe balanca financiare negative prej 407,722 lekësh, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave, janë të karakterit minimal dhe nuk vlerësohen se arrijnë deri në atë masë sa që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	728,254	969,065	965,764	1,170,484	1,255,845	1,541,494	1,959,328	2,053,072	11,287,309	1,872,953	2,272,315	2,013,627	1,993,478	2,069,845
Të ardhura nga paga e subjektit si prokuror	728,254	969,065	965,764	807,130	783,299	970,864	1,120,174	1,054,876	1,124,718	1,108,318	1,045,344	1,241,694	1,208,429	1,224,491
Të ardhura nga paga e subjektit si pedagog	-	-	-	-	-	-	255,780	405,180	-	-	60,300	-	-	-
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	-	-	-	363,354	472,546	570,630	583,374	583,374	638,481	623,990	799,885	771,933	785,049	845,354
Të ardhura nga barrëllindja në llog.bankare T.Bank	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	357,532	-	-	-
Të ardhura nga interesat e depozitës në RBAL	-	-	-	-	-	-	-	4,959	10,514	10,501	9,254	-	-	-
Të ardhura nga interesat e depozitës në T. Bank	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5,144	-	-	-	-
Të ardhura nga interesat në ISP Bank	-	-	-	-	-	-	-	4,683	13,595	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e apartamentit	-	-	-	-	-	-	-	-	9,500,000	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	125,000	-	-	-	-
Detyrime	2,173,800	0	0	0	0	0	0	0	1,020,000	0	0	0	0	0
Kredi bankare 20,000 usd në NBG 13.6.2003 - për blerje shtëpi banimi	2,173,800	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi bankare RBAL 8.4.2011	-	-	-	-	-	-	-	-	1,020,000	-	-	-	-	-
Shpenzime	485,437	719,116	753,155	614,484	785,707	1,357,864	1,042,095	1,256,434	3,596,065	1,775,090	1,800,534	1,973,997	1,882,554	2,103,085
Shpenzime jetike	375,456	273,770	328,671	328,671	409,860	409,860	500,000	500,000	500,000	500,000	800,000	1,100,000	1,150,000	1,300,000
Shpenzime mobilimi	-	250,000	-	-	-	-	-	-	280,000	150,000	-	-	-	-
Shpenzime udhëtimi	-	-	191,309	63,074	177,133	336,205	246,937	218,610	473,676	358,865	216,840	54,951	98,146	67,635
Shpenzime shkollimi *****	-	-	-	-	-	-	80,000	80,000	-	-	-	-	-	150,000
Shpenzime shkollimi *****	-	-	-	-	-	-	-	208,215	345,750	460,377	410,114	521,910	340,684	487,648
Shpenzime kësti_kredia NBG	109,981	195,346	233,176	222,739	198,714	209,798	215,158	249,609	1,563,935	-	-	-	-	-
Shpenzime kësti_kredia RBAL	-	-	-	-	-	-	-	-	224,953	305,848	303,475	297,135	293,724	97,802
Shpenzime rivlerësimi prone	-	-	-	-	-	-	-	-	74,153	-	-	-	-	-
Shpenzime për sistem ngrohje-ftohje	-	-	-	-	-	402,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime për blerje dërguar me western Union	-	-	-	-	-	-	-	-	133,598	-	70,105	-	-	-
Pasuri	2,105,161	1,068	-473	547,773	-81,385	1,492	363,768	-16,889	8,495,967	101,609	-370,971	35,977	189,179	292,481
Kursime (shitesa/pakësime likuiditeti)	(6,904)	1,068	(473)	547,773	(81,385)	1,492	363,768	(141,889)	(452,033)	101,609	(370,971)	35,977	189,179	292,481
Apartament banimi ndërtuar para 1990 sip.75 m2 , 8.3.2003	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Apartament banimi ndërtuar para 1990 sip.73 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Automjet me targë **** 4.6.2010	-	-	-	-	-	-	-	125,000	-	-	-	-	-	-
Apartament 69.4m2, me adrese **** 30.7.2003	2,112,064	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Apartament 112.4m2, me adrese **** 22.11.2011	-	-	-	-	-	-	-	-	8,948,000	-	-	-	-	-
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	311,456	248,881	213,081	8,227	551,523	182,139	553,465	813,527	215,277	-3,746	842,752	3,653	-78,254	-325,721

B. KONTROLI I FIGURËS

10. DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2022, ka përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2022, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, i deklasifikuar pjesërisht (me vendimin nr. ***, datë 11.3.2022, të KDZH-së), dhe nga Grupi i Punës informohet se:

10.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, është përcjellë pranë Komisionit raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

10.2 Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, rezulton se:

a) Për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku ***** mund të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës *****.

b) Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit rezulton se *****.

10.3 Në konfirmimin fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, gjykohet që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

10.4 Komisioni ka administruar përgjigjen e PPKKKO-së⁵⁹, e cila konfirmon se nuk rezulton i regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetasit Florian Bonjaku. Por, ndërkohë, ndaj subjektit rezulton i ardhur materiali me kallëzues N. V., kallëzim i dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

10.5 Komisioni, me rrugë elektronike, në datën 2.12.2021 ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës fashikullin penal nr. ***, me kallëzues shtetasin N. V., i cili kallëzon subjektin Florian Bonjaku dhe 4 subjekte të tjera, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, për shkak të një vendimi mosfillimi të marrë nga subjekti Florian Bonjaku. Kallëzuesi nuk ka qenë dakord me këtë vendim të prokurorisë dhe e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të prokurorisë. Më pas kallëzuesi e ka ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

10.6 Komisioni, nisur nga informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese në lidhje me dyshime për përfshirje të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku në veprimtari të paligjshme, ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë⁶⁰, e cila ka vënë në dispozicion të Komisionit fashikujt penalë të kërkesave të herëpashershme të bëra nga i dënuari S. P. (T.) për ulje dënimi, përfitim amnistie, njohje ditësh paraburgimi etj.

10.7 Nga verifikimi i këtyre fashikujve nuk rezulton që subjekti Florian Bonjaku të ketë qenë palë në këto procese gjyqësore si përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2021, e PPKKKO-së.

⁶⁰Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.1.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

10.8 Komisioni ka administruar gjithashtu përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë⁶¹, e cila ka vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. ***.

10.9 Mbi bazën e materialit të përcjellë nga Komisariati i Policisë Krujë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, në datën 9.5.2019 ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “kultivim të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve T. K., E. K., S. dhe B. D., pasi në një fshat të Krujës janë zbuluar parcela të mbjella me lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*. Referuar dokumentacionit në fashikullin penal, ka rezultuar se:

i) Procedimi penal në ngarkim të shtetasve S. D. dhe B. D., etj. është regjistruar fillimisht si persona në hetim për kryerjen e veprës penale “kultivim të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal. Subjekti ka urdhëruar fillimisht regjistrimin në regjistrin e veprave penale të këtyre shtetasve për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 284/2 të Kodit Penal.

ii) Mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme është vendosur ndalimi i shtetasit B. D. dhe S. D. dhe nga prokurori është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, pasi ka dyshime të arsyeshme që këta shtetas kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

iii) Në kërkesat e përpiluara nga prokurori deri në këtë fazë të hetimit është identifikuar transkriptimi i bisedës që shtetasi B. D. i dërgon një numri tjetër me tekst: “... ”.

iv) Për një periudhë gati 8-mujore këta persona janë hetuar nga prokuroria për veprën penale “kultivim të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

v) Në janar të vitit 2020 e në vijim hetimet për shtetasit B. D. dhe S. D. janë kanalizuar për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe në vijim transkriptimi i bisedës nga teksti i mesazheve që shtetasi B. D. i dërgon një numri tjetër, ka këtë përmbajtje tjetër më të shkurtër dhe pa kuptim: “... ”.

vi) Në datën 27.4.2020 prokurori Florian Bonjaku ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë kërkesën për dërgimin në gjyq të të pandehurve të tjerë të akuzuar për veprën penale “kultivim të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, ndërsa shtetasit B. D. dhe S. D. për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

vii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 18.5.2020, ka vendosur të pranojë kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve T. K., I. D., A. D. dhe N. D., për veprën penale kultivim të lëndëve narkotike” dhe kthimin për rihetim për të pandehurit apo personat nën hetim B. D. e S. D., E. D., B. D. dhe M. L., me argumentin se hetimi nuk është i plotë dhe se nuk janë argumentuar me prova arsyet ligjore të ndryshimit të këtij kualifikimi të veprës penale, duke lënë edhe detyrat përkatëse që duhen kryer nga organi i akuzës, si vijon:

Së pari, të kryhet një aktekspertim topografik për të përcaktuar pozicionin topografik të ndodhjes së pasurisë, si dhe identifikimin e pronësisë apo bashkëpronësisë së kësaj pasurie, përcaktimin nëse personat nën hetim kanë pasuri të paluajtshme pranë zonës në të cilën është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike.

⁶¹Shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.1.2022 dhe nr. *** prot., datë 7.1.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Së dyti, pyetjen e oficerëve të policisë gjyqësore të cilët kanë kryer veprimet e para hetimore lidhur me këtë çështje, si dhe sqarimin në lidhje me arsyet për të cilat kanë referuar edhe emrin e shtetasit E. K. si i përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Së treti, pyetjen e kryeplakut të fshatit në të cilën është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike.

Së katërti, administrimin e dëshmimeve të penalitetit lidhur me personat e dyshuar/të pandehur.

Së pesti, marrjen e informacionit pranë ASHK-së Krujë për pronësinë apo bashkëpronësinë e pasurisë në të cilën është gjetur lënda narkotike.

Së gjashti, marrjen e të dhënave nga kompania telefonike për numrat e telefonit të regjistruara në emër të shtetasit B. D.

Së shtati, kryerjen e një aktekspertimi për të përcaktuar dhe identifikuar zërin e personit të quajtur N., duke krahasuar regjistrimet që rezultojnë nga përgjimet telefonike në bisedat e kryera nga ky shtetas me atë të personit nën hetim B. D.

Së teti, hetimin në lidhje me përfshirjen e mundshme në këtë veprimtari kriminale shtetasin E. K., thirrjen dhe pyetjen e tij, si dhe identifikimin e lidhjes gjinore apo familjare me të pandehurit e tjerë.

viii) Subjekti ka ankimuar vendimin nr. ***, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurve B. D. dhe S. D., për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

ix) Prokuroria e Apelit Tiranë ka kërkuar heqjen dorë nga ankimi ndaj vendimit të datës 18.5.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke argumentuar se ankimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit ka qenë i paplotë dhe jo i gjithanshëm.

x) Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 15.7.2020 ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. *** akti, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkak heqje dorë nga ankimi.

xi) Në datën 11.3.2021, subjekti i rivlerësimit, pas plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata, ka dërguar sërish çështjen në gjyq, ku ka relatuar se pas veprimeve hetimore nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të ndryshonin pozitën procedurale lidhur me pozitën juridike të personave nën hetim B. D. dhe S. D. Nga veprimet hetimore nuk është bërë i mundur dokumentimi me fakte dhe me prova ligjore për të vërtetuar faktin se personi nën hetim S. D. ka konsumuar elementet e veprës penale, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal. Nga transkriptimi i bisedave dhe provave të tjera të marra, rezultoi e provuar se nuk mund të provohej bashkëpunimi i këtij shtetasi në kultivimin e bimëve narkotike, por rezulton se kanë dijeni në lidhje me bimët narkotike të kultivuara nga shtetasi T. K. dhe nuk e ka kallëzuar një fakt të tillë, duke konsumuar veprën penale “moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera rezultoi se dyshimet paraprake lidhur me personat nën hetim B. D. dhe S. D. nuk u kthyen në prova, që mund të bënin të mundur vërtetimin ndaj çdo dyshimi të arsyeshëm që ata kishin në veprimet e tyre, elemente të veprës penale “kultivim të bimëve narkotike”, por rezulton se këto dy persona nuk kanë bërë kallëzim në organet e ndjekjes penale lidhur me këtë fakt dhe në këtë mënyrë kanë konsumuar elementet e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

10.10 Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë⁶² vendimin nr. ***, datë 23.11.2011, nga ku rezulton se gjykata ka gjykuar dhe dënuar të pandehurit S. D. dhe B. D. për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal⁶³.

10.11 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ngriti dyshime në lidhje me ndryshimin e kualifikimit të veprës penale nga “kultivim të bimëve narkotike” në “moskallëzim krimi” për shtetasit B. D. dhe S. D., duke konstatuar si vijon:

a) Transkriptimi i bisedës së mesazheve së dërguar nga numri ***, që i përket shtetasit B. D., dërguar një numri tjetër, në kërkesën për gjykim të datës 11.3.2021 të subjektit Florian Bonjaku nuk është i plotë krahasuar me tekstin e po këtij transkriptimi të pasqyruar në aktet e hetimit kur këta shtetas ishin në hetim për veprën penale “kultivim të bimëve narkotike”.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka çmuar vlerën, rëndësinë e kësaj prove (transkriptimi i mesazheve) dhe të përmbajtjes së tij në raport me provat e tjera, duke zbehur kështu vlefshmërinë procedurale të saj, me qëllim lehtësimin e pozitës së dy të pandehurve. Si rrjedhojë, për këta dy të pandehur subjekti duket se e ka kualifikuar veprën penale në atë kategori për të cilën ligji parashikon një dënim më të lehtë sesa vepra penale në ngarkim të të pandehurve të tjerë, në kundërshtim me nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale.

c) Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, nuk ka argumentuar arsyen përse për të dy të pandehurit, të cilët ndodhen në kushte të njëjta akuzuar për të njëjtën vepër penale, ka mbajtur qëndrim ndryshe në individualizimin e dënimit (duke aplikuar vetëm për të pandehurin B. D. nenin 59 të Kodit Penal).

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.12 Subjekti ka shpjeguar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk ka çmuar se në aktet e dërguara për gjykim nga ana e prokurorisë kishte fakte penale që nuk janë përmendur në kërkesën për gjykim, por thjesht ka kërkuar plotësimin e hetimeve, duke i lënë detyra konkrete organit të prokurorisë, të përmendura më lart. Në rast se kjo gjykatë do të vërente se akuza e ngritur për shtetasit S. D. dhe B. D. nuk ishte e saktë, atëherë bazuar në nenin 332/d, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, do t'i kthente aktet prokurorit, duke e orientuar drejtimin e hetimeve për ngritjen e një akuze të ndryshme dhe jo vetëm kryerjen e hetimeve shtesë nga organi i akuzës. Në kuadër të përcaktimeve ligjore të pikës 3/c të nenit 329 dhe pikës 3, të nenit

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁶³Në konkluzionet përfundimtare, subjekti ka kërkuar: “1. Deklarimin fajtor të të pandehurit S. D. për kryerjen e veprës penale ‘moskallëzim krimi’ dhe dënimin e tij me 2 vite burgim dhe mbi këtë masë dënimi të aplikohet neni 406 i Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht me 16 muaj, si dhe shuarjen e masës së sigurimit personal. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. D. për kryerjen e veprës penale ‘moskallëzim krimi’ dhe dënimin e tij me 2 vite burgim dhe mbi këtë masë dënimi të aplikohet neni 406 i Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht me 16 muaj burgim, si dhe aplikim të nenit 59 të Kodit Penal për pjesën e mbetur të dënimit”. Gjykata ka vendosur: “1. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. D. për kryerjen e veprës penale ‘moskallëzim krimi’ dhe dënimin e tij me 24 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 16 muaj burgim. Pas zbritjes së kohës së masës së sigurimit masa e mbetur e dënimit është 3 muaj. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, duke e vënë të pandehurin në shërbim prove për 6 muaj. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit S. D. për kryerjen e veprës penale ‘moskallëzim krimi’ dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim...”.

329/b, të Kodit të Procedurës Penale gjykata nuk ka urdhëruar prokurorin që të formulojë akuzë apo ndonjë cilësim juridik të ndryshëm të faktit penal objekt gjykimi, përkundrazi, gjykata urdhëroi vetëm kryerjen e disa veprimeve hetimore.

Pas realizimit të detyrave të lëna nga gjykata, nuk rezultoi e provuar se shtetasit S. D. dhe B. D. të kenë kryer veprën penale “kultivim të lëndëve narkotike”, pasi për personat nën hetim nuk ka biseda të tjera dhe prokuroria nuk bëri të mundur dokumentimin me fakte dhe prova për të vërtetuar që dy shtetasit kanë konsumuar këtë vepër penale.

Lidhur me pretendimin se transkriptimi i bisedës nuk është i plotë, subjekti shpjegon se nga ana e tij si prokuror i çështjes në fashikullin e gjykimit dërguar gjykatës janë futur të plota të gjitha procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve dhe komunikimeve që janë kryer lidhur me këtë procedim penal, duke mos anashkaluar asnjërin prej tyre.

Por, nga ana tjetër, rezulton se gjykata e ka administruar si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor transkriptin e plotë të bisedës që përmban mesazhin e dërguar nga numri i telefonit ***, i cili i përket shtetasit B. D., dërguar një tjetër numri. Në këto kushte, vendimi i gjykatës që ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurit S. D. dhe B. D. për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, në kuptim të detyrimit që sanksionon neni 382, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, është analizuar nga gjykata, që përsëri ka konkluduar në vendimmarrjen e saj në të njëjtin kualifikim ligjor me atë të prokurorit.

Pra, në rastin konkret, rezulton se nga hetimet nuk u përfituan prova që të bindnin dhe të nxirnin tërësisht në pah fajësinë e të pandehurit në çështjen në fjalë.

Dyshimi në favor të të pandehurit nënkupton se, kur faktet dhe rrethanat e çështjes lejojnë vlerësime dhe interpretime të ndryshme, duhet pranuar ai interpretim që është më i favorshëm për personin nën hetim. Vendimmarrja e prokurorit për këtë çështje është vlerësuar e drejtë dhe e saktë edhe nga gjykata dhe kjo çështje është ende në gjykim, në pritje të shqyrtimit dhe të një vendimmarrjeje nga Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në ankimet e ushtruara nga të pandehurit.

I pyetur në seancën dëgjimore për faktin se të dhënat e transkriptimit ishin të mjaftueshme për të proceduar dy të pandehurit për veprën penale “kultivim dhe shitje të narkotikëve” dhe jo të veprës penale “moskallëzim krimi”, subjekti theksoi se në bindjen e tij, në bindjen dhe vendimmarrjen e gjykatës, një përgjim i vetëm nuk ishte i mjaftueshëm për t’i ngarkuar dy shtetasve akuzën për kultivim bimësh narkotike sepse mbetej përgjim i vetëm dhe nuk lidhej me asnjë provë tjetër. Gjithashtu, nuk lidhej edhe me ditët kur nga forcat e policisë u kapën sasi lëndësh narkotike që mund t’i atribuonin njërin prej tyre dhe me asnjë provë tjetër. Pra, një përgjim i vetëm mund të shërbejë si *indicie*, por nuk mund të krijonte një provë të plotë për të ngritur akuzën në fjalë. Subjekti shpjegoi se në 6 muaj përgjime për personin në fjalë ishte vetëm ky përgjim.

Gjykata nuk ka marrë vendim bazuar vetëm në kërkesën e subjektit për gjykim, por ajo ka pasur në dispozicion të gjitha aktet, transkriptimet e plota, përgjigjet e plota etj.

Lidhur me faktin e pretenduar nga Komisioni se në konkluzionet përfundimtare nuk është argumentuar arsyeja përse për të dy të pandehurit, të cilët ndodhen në kushte të njëjta, akuzuar për të njëjtën vepër penale, ka mbajtur qëndrim ndryshe në individualizimin e dënimit, duke aplikuar vetëm për të pandehurin B. D. nenin 59 të Kodit Penal, subjekti shpjegon se ky nen

nuk lidhet vetëm me faktin nëse të pandehurit kanë konsumuar ose jo të njëjtën veprë penale, por duhet të përmbushen edhe disa shkaqe dhe elemente të tjera ligjore për zbatimin e këtij dënimi alternativë, referuar parimit të individualizimit të dënimit, si vijon: *“Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit”*.

Duhet theksuar fakti se dy të pandehurit kanë qenë në masa të ndryshme të sigurimit personal, ku shtetasit B. D. i është caktuar masa e sigurimit personal “detyrim paraqitjeje”, ndërsa shtetasit S. D. ajo me “arrest shtëpie”. Gjithashtu, për të pandehurin B. D. është marrë në konsideratë fakti se në kohën e kryerjes së veprës penale ishte në moshë relativisht të re dhe duke ndjekur studimet, si dhe shkalla e ulët e rrezikshmërisë së tij, i cili rezultoi të jetë i padënuar më parë (bashkëlidhur gjeni vendimin nr. ***, datë 24.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë).

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.13 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë çështje. Kërkesa për gjykim e subjektit të rivlerësimit nuk është bazuar vetëm në një përgjim të vetëm, por është hartuar në kompleksitet me provat e tjera që u përfituan edhe nga hetimet shtesë pas detyrave të lëna nga gjykata e shkallës së parë.

Komisioni analizoi edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila ia ktheu kërkesën për gjykim subjektit për hetime të mëtejshme, pasi nuk kishte argumentuar mirë kërkesën për të pandehurit S. D. dhe B. D., duke i caktuar kryerjen e veprimeve hetimore të tjera⁶⁴, por këto veprime nuk përfshinë si element faktin se duheshin rihetuar transkriptimet e bisedave të të pandehurve. Nga ana e prokurorisë u plotësuan detyrat e lëna nga gjykata, si: u administrua akt ekspertimi topografik i datës 16.2.2021, nga ku rezultoi se ngastrat ku janë gjetur të kultivuara lëndët narkotike ndodhen në një pasuri të llojit “pyll” e administruar nga ASHK-ja Krujë, të cilat ndodhen larg tokave bujqësore të personave nën hetim S. D., B. D. etj. Gjithashtu, nga verifikimi në ASHK-në Krujë tokat ku është gjetur lënda narkotike janë në pronësi të pronarit “shtet”. Sipas detyrave të lëna nga gjykata, kryeplakut të fshatit *** i janë marrë deklaramë në lidhje me shtetasin B. D. dhe nga ky i fundit u sqarua që gjithmonë ka pasur bashkëpunim me policinë, por nuk ka pasur dijeni për bimët narkotike, pasi vendi ku është gjetur është zonë pyll dhe në kufi me fshatin ***, dhe pronë shtet. Nga verifikimi në kompanitë celulare, rezultoi se shtetasi B. D. ka në përdorim numrin përkatës. Policisë shkencore i është kërkuar ekspertiza e

⁶⁴1. Të kryhet një aktekspertimi topografik për të përcaktuar pozicionin topografik të ndodhjes së pasurisë, si dhe identifikimin e pronësisë apo bashkëpronësisë së kësaj pasurie, përcaktimin nëse personat nën hetim kanë pasuri të paluajtshme pranë zonës në të cilën është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike; 2. pyetjen e oficerëve të policisë gjyqësore të cilët kanë kryer veprimet e para hetimore lidhur me këtë çështje, si dhe sqarimin në lidhje me arsyet për të cilat kanë referuar edhe emrin e shtetasit E. K., si i përfshirë në këtë veprimtari kriminale; 3. pyetjen e kryeplakut të fshatit në të cilin është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike; 4. administrimin e dëshmimeve të penaltetit lidhur me personat e dyshuar/të pandehur; 5. marrjen e informacionit pranë ASHK-së Krujë për pronësinë apo bashkëpronësinë e pasurisë në të cilën është gjetur lënda narkotike; 6. marrjen e të dhënave nga kompania telefonike për numrat e telefonit të regjistruara në emër të shtetasit B. D.; 7. kryerjen e një aktekspertimi për të përcaktuar dhe identifikuar zërin e personit të quajtur N., duke krahasuar regjistrimet që rezultojnë nga përgjimet telefonike në bisedat e kryera nga ky shtetas me atë të personit nën hetim B. D.; 8. hetimin në lidhje me përfshirjen e mundshme në këtë veprimtari kriminale shtetasin E. K., thirrjen e pyetjen e tij dhe identifikimin e lidhjes gjinore apo familjare me të pandehurit e tjerë.

zërit për të përcaktuar dhe identifikuar zërin e shtetasit N. D., duke e krahasuar me zërin e shtetasit B. D. dhe nga ky institucion konfirmohet se ky lloj ekspertimi nuk mund të realizohet.

Është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit S. D., nga i cili nuk rezultoi të jenë gjetur sende të kundërligjshme. Nga transkriptimi i bisedave rezultoi e provuar se nuk mund të provohej bashkëpunimi i këtij shtetasi në kultivimin e narkotikëve, por rezulton se ka dijeni më lidhje me bimët narkotike të kultivuara nga shtetasi T. K. në fshatin B., vërtetuar nga bisedat me këtë shtetas në datën 18.5.2019. Fakti që nuk ka kallëzuar një gjë të tillë, rezulton se ka konsumuar elementet e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Për shtetasin B. D., i cili ka rezultuar se ka përdorur numrin e telefonit ***, regjistruar në emër të vëllait të tij E. D., por të përdorur prej tij, është bërë këqyrja e telefonit, nga e cila nuk u konstatuan të dhëna me interes për hetimin.

Nga transkriptimet rezulton se nuk ka biseda të tjera përveçse biseda e datës 17.6.2019 me shtetasin A. D., nga ku del se ai ka dijeni në lidhje me bimët narkotike të kultivuara nga ky shtetas, por që ka konsumuar veprën penale “moskallëzim krimi”.

Nga ana e shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Krujë janë përpiluar 7 urdhra shërbimi për periudhën maj - korrik 2019 dhe 5 raporte shërbimi të kontrollit të vendeve, ku mendohej se kultivohej lënda narkotike, dhe ka rezultuar se i pandehuri T. K. dhe të pandehurit e tjerë kanë komunikuar me anë të telefonit dhe njoftonin njëri-tjetrin për praninë e policisë, fakt ky që ka provuar se bimët narkotike të gjetura nga policia në këto aksione janë mbjellë nga këta të pandehur.

Ndërkohë që gjatë këtyre raporteve të shërbimit, nga shtetasi S. D. rezulton vetëm biseda me mesazh, referuar transkriptimit të datës 18.5.2019 dhe asnjë bisedë tjetër në datat e kontrolleve të bëra nga policia.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, edhe pas plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata, përsëri dërgoi në këtë të fundit kërkesën për gjykim të të pandehurve S. D. dhe B. D. për veprën penale “moskallëzim krimi”, sipas bindjes së krijuar prej tij nga hetimi. Kjo kërkesë u pranua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, gjykuar nga një gjyqtare tjetër, pra duke mbajtur të njëjtin qëndrim me subjektin dhe duke vijuar me dënimin e dy të pandehurve për veprën penale “moskallëzim krimi”. Pra, gjykata, duke pranuar kërkesën e prokurorisë për gjykimin e dy të pandehurve për veprën penale “moskallëzim krimi”, ka dhënë vendim duke i dënuar për këtë vepër penale, bazuar në të gjitha provat e grumbulluara gjatë hetimit nga ana e prokurorisë, duke i gjetur kështu të drejta dhe në përputhje me ligjin veprimet hetimore e procedurale të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni, marrë për bazë deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore, transkriptimet, provat e administruara gjatë hetimit, si dhe vendimin e gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit pa ndryshuar kualifikimin e veprës penale për dy të pandehurit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet e duhura procedurale, kjo edhe nën dritën e detyrave të lëna nga gjykata, por pavarësisht sa më lart, Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se vlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, bazohet pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit.

Në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal vetëm për një nga të pandehurit kur të dy gjykoreshin për të njëjtën vepër penale, subjekti dha shpjegime të mjaftueshme lidhur me arsyet e aplikimit të kësaj dispozite të cilat nuk gjendeshin të pasqyruara në konkluzionet përfundimtare të çështjes ku hetoheshin të pandehurit S. D. dhe B. D.

10.14 Nga hetimi administrativ rezultoi se bazuar në nenin 38, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal, që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramentit.

10.15 Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave në këtë deklaratë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë përfshirë në veprimtari të paligjshme apo të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

10.16 Komisioni, nisur nga informacioni i marrë nga organet ligjzbatuese se subjekti është përfshirë në veprime korruptive, ka kryer hetime në drejtim të një çështjeje të analizuar si më sipër, ku pas analizimit të saj nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime që bien në kundërshtim me ligjin procedural dhe material dhe nuk u provua që ai të ishte përfshirë në veprime korruptive.

10.17 Komisioni, bazuar në hetimin administrativ dhe shpjegimet e subjektit, arriti në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 17.12.2020, për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku.

11.1 Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira profesionale, organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

11.2 Subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm për aftësitë e tij profesionale dhe etike, është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2013 – 2016.

11.3 Tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

11.3.1 Dokumenti 1 – konkluzione lidhur me kërkesën për njohje të vendimeve penale të huaja për të dënuarin G. Gj. me burgim të përjetshëm nga autoritetet italiane, në kuadër të njohjes së vendimit penal të autoriteteve gjyqësore italiane, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11.3.2 Dokumenti 2 – vendim për mosfillimin e procedimit penal “për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2016” në ngarkim të shtetasit N. K., akuzuar për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Për këtë dokument Komisioni administroi përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë⁶⁵, e cila ka dërguar fashikullin e kallëzimit penal nr.***.

Pas analizimit të dokumentacionit të kësaj dosjeje Komisioni nuk konstatoi problematika.

11.3.3 Dokumenti 3 – kërkesë për gjykimin e çështjes nr. *** të vitit 2016, në ngarkim të shtetasit D. A., akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe dënimin e tij me burgim⁶⁶.

Komisioni vëren se nga Grupi i Punës pranë KLP-së, si dhe pas analizës së tri dokumenteve nga Komisioni, nuk konstatohen problematika.

11.4 Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, referuar raportit të Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së

11.4.1 Dosja 1 – praktikë ekzekutimi nr. ***, datë 26.2.2014. Shkresë e konceptuar nga subjekti i rivlerësimit për dërgimin e materialeve të kërkuara nga IEVP, rruga “****”, Tiranë, për plotësim dosje penale.

11.4.2 Dosja 2 – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 5.5.2016, për kallëzimin penal nr. ***, datë 5.4.2016, referuar nga Komisariati i Fushë-Krujës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

11.4.3 Dosja 3 – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë”⁶⁷.

11.4.4 Dosja 4 – vendim “Për pushimin e çështjes penale” për procedimin penal nr. ***, regjistruar në datën 3.6.2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁸.

11.4.5 Dosja 5 – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”, datë 3.1.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁹.

Komisioni vëren se pas administrimit dhe analizës së dokumentacionit, përfshirë edhe hapat hetimorë, proceduralë të kryer nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga raporti i Grupit të Punës pranë KLP-së, nuk u konstatuan problematika në pesë dosjet e përzgjedhura me short, për sa i përket kriterit profesional.

11.5 Në lidhje me ankesat/masat disiplinore dhe kallëzimet

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁶⁶I pandehuri D. A., me detyrë përgjegjës i sektorit ligjor në IEVP, me veprimet e paligjshme ka liruar një të burgosur të dënuar me vendim të formës së prerë.

⁶⁷Në ngarkim të të pandehurit A. B., akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, për të cilin subjekti Florian Bonjaku ka kërkuar në gjykatë dënimin e tij me 9 muaj burgim, duke aplikuar edhe nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁸Për kallëzimin e bërë nga shtetasi A. Sh. për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe “vjedhje”, pasi motori i konfiskuar në Komisariatin nr. *** është gjetur dhe i është kthyer përsëri kallëzuesit.

⁶⁹Në ngarkim të të pandehurit S. G., akuzuar për veprën penale “dhunë në familje” dhe është kërkuar dënimi i të pandehurit me 13 vjet e 15 ditë burgim.

11.5.1 Prokuroria e Përgjithshme⁷⁰ ka përcjellë informacion për subjektin e rivlerësimit Florian Bonjaku, të ardhur nga prokuroritë e rretheve gjyqësore.

11.5.2 Në regjistrat e ankesave në sektorin e protokoll-arkivit⁷¹, gjatë viteve 2006 – 2019 rezultojnë dy ankesa, të cilat pas shqyrtimit janë arkivuar nga Prokuroria e Përgjithshme⁷².

11.5.3 Nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme⁷³, nuk rezulton që subjekti Florian Bonjaku të ketë masa disiplinore gjatë karrierës së tij profesionale.

11.5.4 Nuk rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit të ketë pasur procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore të poshtëshënuara⁷⁴.

11.5.5 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë⁷⁵ konfirmon se pranë saj është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 18.6.2018, i shtetasit K. V., për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu rezulton i regjistruar kallëzimi penal nr.***, datë 17.3.2019, mbi kallëzimin e të dënuarit I. K., për veprën penale “shpërdorim detyre”, i cili është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

11.5.6 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin⁷⁶ ka dërguar informacion se në emër të shtetasit Florian Bonjaku janë regjistruar dy materiale kallëzuese nr. *** të vitit 2018⁷⁷ dhe nr. *** të vitit 2019⁷⁸, për veprën penale “shpërdorim detyre”, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi faktet e pretenduara në këto kallëzime penale nuk përbëjnë vepër penale.

11.5.7 Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁹ rezulton se për periudhën 2010 – 2020 janë regjistruar 4 kallëzime penale ndaj subjektit Florian Bonjaku dhe subjekteve të tjera, për të cilat

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

⁷¹Shkresat nr. *** prot., datë 4.8.2020 dhe nr. *** prot., datë 5.2.2020, të sektorit të protokoll-arkivit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

⁷²Ankesë nr. *** e vitit 2018, e shtetasi P. Ll., për vendimin e pushimit të çështjes nr. ***, datë 10.10.2018, marrë nga prokurori Florian Bonjaku, me pretendimin se vendimi ka qenë i pabazuar në ligj dhe prova. Ankuesi pretendon se ankimin ndaj këtij vendimi e ka bërë brenda afatit ligjor përpara Prokurorit të Përgjithshëm. Ankuesi ka referuar një bazë ligjore, e cila tashmë është shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, që do të thotë që Prokurori i Përgjithshëm nuk ka më kompetencë ligjore të shfuqizojë vendimet e prokurorëve të tjerë, pasi vendimmarrja e tyre shqyrtohet vetëm nga gjykata. Ankesa nr. *** e vitit 2018, e shtetasit Q. M., i cili është drejtuar disa herë Prokurorisë së Përgjithshme për një prishje ndërtimi të paligjshëm në pronësi të tij. Këto ankesa janë trajtuar si në kallëzimin penal nr. *** të vitit 2017, mosfilluar në datën 7.12.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë, ashtu edhe në kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019 të mosfilluar nga po e njëjta prokurori.

⁷³Shkresat nr. *** prot., datë 7.7.2020 dhe nr. *** prot., datë 3.7.2020, të Prokurorisë së Përgjithshme.

⁷⁴Shkresat: nr. *** prot., datë 6.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Kukës; nr. *** prot., datë 7.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Lezhë; nr. *** prot., datë 9.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Dibër; nr. *** prot., datë 17.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Kavajë; nr. *** prot., datë 15.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Korçë; nr. *** prot., datë 3.7.2020, Prokurorisë së Rrethit Vlorë; nr. *** prot., datë 7.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Pogradec; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Sarandë; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Shkodër; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Tropojë; nr. *** prot., datë 3.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Përmet; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Mat; nr. *** prot., datë 3.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë; nr. *** prot., datë 6.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Lushnje; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Pukë; nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Fier; nr. *** prot., datë 3.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Berat; nr. *** prot., datë 6.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Elbasan; nr. *** prot., datë 14.7.2020, e Prokurorisë së Rrethit Durrës.

⁷⁵Shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2021, e Prokurorisë së Rrethit Krujë.

⁷⁶Prokuroria e Rrethit Kurbin, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2020.

⁷⁷Kallëzim i bërë nga shtetasi K. V., me pretendimin se nga subjekti si prokuror i çështjes është kërkuar shpallja e moskompetencës tokësore lidhur me këtë procedim penal.

⁷⁸Kallëzim i bërë nga i dënuari I. K., me pretendimin se nga subjekti Florian Bonjaku i është rënduar pozita e tij nga dënimi i dhënë nga autoritetet greke me 56 vjet burgim (pjesa e pakryer 25 vjet burgim) dhe subjekti ka kërkuar njohjen e këtij vendimi penal.

⁷⁹Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale⁸⁰.

11.6 PPKKKO-ja⁸¹ ka referuar se nga verifikimet e kryera rezulton se emri i shtetasit Florian Bonjaku është përmendur në kallëzimet nr.***⁸² dhe ***⁸³ të bërë nga i njëjti shtetas, Sh. M., me pretendimin se subjekti Florian Bonjaku ka kryer veprime korruptive. Pas hetimit të këtyre kallëzimeve nga kjo prokurori, për të dy kallëzimet është vendosur mosfillim procedimi, pasi pretendimet e ngritura në kallëzim nuk përmbajnë elemente të veprës penale.

DENONCIME/ANKESA NGA PUBLIKU

12. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 5 denoncime/ankesa nga publiku.

12.1 Denoncim nr. *** prot., datë 13.2.2019, i shtetasit Sh. M., i cili pretendon për Drejtuesin e Prokurorisë Krujë dhe subjektin Florian Bonjaku për shpërdorim detyre, korrupsion për një vendim pushimi, ankesë kjo e njëjtë me kallëzimin e bërë po nga ky shtetas, trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme, referuar në pikën 11.5.2 të vendimit.

12.2 Denoncim nr. *** prot., datë 14.6.2018, i shtetasit K. V., i cili ka bërë kallëzim për subjektin Florian Bonjaku për veprën penale “shpërdorim detyre”, kallëzim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Komisioni vëren se kallëzimi i bërë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është objekt shqyrtimi i Komisionit.

12.3 Denoncim nr. *** prot., datë 26.6.2019. i shtetasit P. Ll., i cili ngre ankesa ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe ndaj subjektit Florian Bonjaku, të cilët kanë hetuar dhe gjykuar disa çështje të tij ku janë pushuar nga prokuroria dhe janë rrëzuar nga gjykatat, për të cilët pretendon për shpërdorim detyre dhe përfitime të paligjshme.

Komisioni vëren se pas analizës së këtyre denoncimeve, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur nga denoncuesit, nuk janë konstatuar *indicie* apo prova që e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, për sa i përket kriterit profesional.

12.4 Denoncimi nr. *** prot., datë 3.6.2019, i shtetasit R. M., i cili pretendon se nuk ka marrë asnjë lloj njoftimi për ecurinë e hetimit dhe asnjë lloj informacioni për çështjen e tij që hetohet nga subjekti Florian Bonjaku.

⁸⁰(i) Kallëzimi penal nr. ***, datë 3.1.2013, i shtetasit T. D. (ish-subjekt prokuror i shkarkuar nga Presidenti me procedurë të iniciuar nga Prokurori i Përgjithshëm për shkelje në ushtrimin e detyrës), i cili ka kallëzuar subjektet S. S., A. Q. dhe Florian Bonjaku, për veprën penale “shpërdorim detyre”, i cili është mosfilluar në datën 26.1.2013, pasi fakti i parashtruar nuk parashikohet nga ligji si veprë penale; (ii) kallëzimi penal nr. ***, datë 11.9.2013, i shtetasit O. N. (i dënuar për prodhim dhe shitje narkotikësh), i cili ka kallëzuar subjektin Florian Bonjaku për një vendimarrje. Në datën 13.9.2013 është vendosur mosfillimi i këtij procedimi penal, pasi fakti nuk është i parashikuar si veprë penale; (iii) kallëzimi penal nr. ***, datë 25.2.2020, i shtetasit I. Xh., i cili ka bërë kallëzim ndaj zyrtarëve të Komisarariatit të Policisë Fushë-Krujë dhe subjektit Florian Bonjaku për veprën penale “shpërdorim detyre për vendimarrje”. Në datën 10.3.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti nuk përmban elementë të ndonjë veprë penale; (iv) kallëzimi penal nr. ***, datë 25.2.2020, i shtetasit I. Xh., i cili ka bërë kallëzim ndaj zyrtarëve të Komisarariatit të Policisë Fushë-Krujë dhe subjektit Florian Bonjaku për veprën penale “shpërdorim detyrës për vendimarrje”. Në datën 9.3.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti nuk përmban elementë të ndonjë veprë penale.

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, e PPKKO-së.

⁸²Kallëzim për veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, me pretendimin se u është pushuar çështja e pushtimit të tokës për shkak se vepra penale ishte amnistuar me ligjin nr. 141/2016 dhe ndaj këtij vendimi kallëzuesi Sh. M. nuk ka ushtruar ankim në gjykatë etj.

⁸³Kallëzim për veprën penale “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, me pretendimin se prokurorët e përfshirë dhe subjekti kanë marrë përfitime në të holla për vendimet e dhëna.

12.4.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë⁸⁴ fashikullin penal nr.***, me kallëzues R. M., nga ku është konstatuar se:

- a) Kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. ***, drejtuar Gjykatës së Rrethit Krujë, i është njoftuar vetëm personit të dyshuar B. G. (e pasqyruar në kërkesën për pushim nga subjekti Florian Bonjaku) dhe jo kallëzuesit R. M., në kundërshtim me nenin 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka zgjatur hetimet çdo 3 muaj për një periudhë gati 2-vjeçare (9.11.2019 – 9.11.2021) me arsye marrje dokumentacioni shtesë nga Bashkia Krujë, ndërkohë që kërkesa i është dërguar bashkisë në datën 10.3.2021, pas 15 muajsh, në kundërshtim me nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- c) Nuk rezulton që vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve t’iu jenë njoftuar palëve të interesuara, sipas përcaktimeve të nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.4.2 Subjekti ka shpjeguar se pavarësisht parashikimit ligjor, mosnjoftimi i kallëzuesit nga prokurori në përfundim të hetimeve, kur procedohet me pushimin e akuzës, nuk cenon të drejta procedurale të kallëzuesit, teksa pas komunikimit kallëzuesi nuk mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të tjera nga prokurori. Neni 329/a, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale parashikon vetëm të drejtën e të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim, që të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre, por jo të drejtën e tyre për të kërkuar veprime hetimore shtesë. Gjithashtu, ky nen nuk parashikon pasojat procedurale që vijnë nga mosnjoftimi i kësaj kërkesë.

Në lidhje me konstatimin e zgjatjes së hetimeve çdo 3 muaj për një periudhë gati 2-vjeçare, subjekti shpjegon se Komisioni duhet të ketë parasysh që gjatë kësaj periudhe, për shkak të procesit të *Vetting*-ut, volumi i punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve është rritur ndjeshëm jashtë çdo mundësie objektive për kryerjen e një kohe të shkurtër të veprimeve hetimore.

Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve palëve të interesuara, subjekti shpjegon se si prokuror ka urdhëruar njoftimin e vendimit tek të interesuarit. Në rastin konkret vendimi i është njoftuar shtetasit B. G. si person ndaj të cilit zhvillohen hetime. Ndërsa për detyrimin e komunikimit të vendimit tek i dëmtuari, në këtë çështje konstatohet se kallëzuesi R. M. nuk e ka pasur këtë status, pra të të dëmtuarit, pasi nuk vërtetohet që të ketë qenë pronar i tokës. Në këto kushte, duke mos pasur statusin e të dëmtuarit, mosnjoftimi i vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve tek shtetasi R. M. nuk cenon asnjë të drejtë procedurale të tij dhe as vetë cilësinë e hetimit, e cila në rastin konkret, përveç kohëzgjatjes për arsye objektive, rezulton se ka qenë i plotë.

⁸⁴Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

12.4.3 Komisioni vëren se me gjithë shpjegimet e subjektit, neni 329/a/4 i Kodit të Procedurës Penale e ka të përcaktuar qartë që kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes i njoftohet edhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Për sa kohë është e përcaktuar proceduralisht, subjekti ka pasur detyrë ta njoftonte kallëzuesin dhe nuk ka lidhje me pasojën e mosnjoftimit të këtij vendimi. Njoftimi është një kërkesë procedurale, e cila duhet të përmbushet nga prokurori i çështjes.

Për zgjatjen e afatit të hetimeve për një periudhë 2-vjeçare, kur vetëm pas 15 muajsh subjekti ndërmerr një veprim hetimor (dërgim shkresë tek Bashkia Krujë) ngarkesa në punë e pretenduar nga subjekti nuk përbën shkak që ta shtyjë pambarimisht hetimin të kushtëzuar vetëm në dërgimin e një shkresë për marrje informacioni.

Për mosnjoftimin e shtetasit R. M. me arsyen se nuk ka statusin e të dëmtuarit në kallëzim, Komisioni vëren se ky arsyetim nuk qëndron, për sa kohë që edhe shtetasi B. G., i cili është njoftuar nga subjekti, nuk ka statusin e të pandehurit (siç përcakton Kodi i Procedurës Penale), por statusin e personit nën hetim.

Komisioni vlerëson se këto mangësi procedurale të konstatuara nuk arrijnë deri në atë nivel sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

12.5 Denoncimi nr. *** prot., datë 2.6.2020, i shtetasit M. H., i cili ka bërë kallëzim në datën 11.12.2018 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe ngre ankesë për subjektin Florian Bonjaku, pasi nuk ka kryer asnjë veprim për rreth 18 muaj. Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë⁸⁵ fashikullin penal nr. ***, me kallëzues M. H., nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku ka dërguar kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

12.5.1 Nga analiza e kësaj dosjeje është konstatuar se kërkesa për pushimin e çështjes penale nuk u është njoftuar palëve të interesuara, në përputhje me nenin 329/a/4. Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.5.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se Komisioni gjatë vlerësimit duhet të mbajë parasysh se për shkak të procesit *Vetting* volumi i punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve është rritur shumë jashtë çdo mundësie objektive për kryerjen në një kohë të shkurtër të veprimeve hetimore. Mungesa e komunikimit, si më lart, nuk përbën shkak për kthimin e akteve nga gjykata, kjo për vetë faktin se kërkesa i është komunikuar kallëzuesit nga vetë gjykata dhe kallëzuesi, në këtë mënyrë, ka pasur mundësi të parashtrijë pretendimet e tij në lidhje me këtë kërkesë dhe të kërkojë para gjykatës, ndër të tjera, edhe kthimin e akteve prokurorisë me qëllim që të kryhen veprime hetimore shtesë prej saj.

⁸⁵Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

12.5.3 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur kërkesat procedurale (mosnjoftimi i kërkesës për pushim palëve) për shkak të ngarkesës në punë.

Komisioni vëren se kjo mangësi procedurale nuk vlerësohet se arrin deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave, kushteve, fakteve dhe shpjegimeve të subjektit, si më sipër, bazuar në analizën e vlerësimit të aftësive profesionale të kërkuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmon se problematikat e konstatuara në veprimet apo mosveprimet procedurale të subjektit, për mënyrën se si subjekti ka performuar në raport me të drejtën dhe legjislacionin, në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror, janë të karakterit minimal, të cilat nuk arrijnë deri në atë nivel sa të ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku:

- a) Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, konsiderohen si pasaktësi me peshë minimale dhe që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara dhe shpenzimet e kryera, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 407,722 lekë, për periudhën 2003 – 2016, balancë e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 2.6.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese/kundër

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj